



**KONGRESI  
RINOR  
KOMBËTAR**



**KONRAD  
ADENAUER  
STIFTUNG**

# **IMPLEMENTIMI I LIGJIT PËR RININË PËRCEPTIMI I TË RINJVE DHE OSHC-VE**

**DHJETOR 2022**

**Autorë:** Dafina PEÇI, Enxhi LIPA, Rigels XHEMOLLARI

# PARATHËNIE

Programi i Kërkimit, Monitorimit dhe Vlerësimit është një ndër shtyllat kryesore të punës së Kongresit Rinor Kombëtar. Ky program ka në thelb kërkimin shkencor të bazuar në fakte dhe vlerësimin e politikave publike në nivel lokal e qendror duke përfshirë monitorimin e institucioneve lidhur me programet, politikat apo iniciativat që ata i dedikojnë të rinjve. Kongresi Rinor Kombëtar me suportin e plotë të Fondacionit Gjerman Konrad Adenauer që prej vitit 2019 i ka kushtuar një vëmendje të veçantë zhvillimeve të Ligjit 75/2019 "Për Rininë" duke qenë se ky ligj po implementohet për herë të parë në Shqipëri.

Fillimisht ky ligj ka qenë objekt diskutimi midis organizatave të shoqërisë civile, ku pas një turi konsultimesh Kongresi Rinor Kombëtar ka dalë me një deklaratë publike lidhur me shqetësimet dhe problematikat e draft ligjit "Për Rininë". Përpos problematikave dhe sugjerimeve të propozuara nga OSHC-të ky ligj u aprovua nga Kuvendi i Shqipërisë dhe ka nisur zbatimin që prej 11 Nëntorit të vitit 2019. Ky ligj parashikon ngritjen e disa mekanizmave dhe institucioneve të cilat prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë hartimin dhe implementimin e politikave rinore në nivel qendror e lokal si Agjencia Kombëtare e Rinisë, Këshilli Kombëtar Rinor, Këshillat Vendor Rinor dhe Organizata Kombëtare Përfaqësuese. Gjithashtu, ky ligj parashikon një sërë përgjegjësish edhe për 61 bashkitë e vendit.


Për këtë arsye, në vitin 2021, Kongresi Rinor Kombëtar ka publikuar të vetmin raport monitorimi dhe vlerësimi mbi zbatimin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë" në Shqipëri, i titulluar «Sfidat dhe Efektet e Zbatimit të Ligjit 75/2019 "Për Rininë»». Ky raport përmban një sërë të dhënash sasiore dhe cilësore mbi implementimin e këtij ligji në nivel qendror e lokal, duke bërë një analizë mbi ecurinë e këtij ligji, sfidat dhe problemet ekzistuese dhe duke paraqitur një sërë rekomandimesh për përmirësimin e situatës aktuale.

Kongresi Rinor Kombëtar, në vijim të punës tre vjeçare mbi vlerësimin dhe monitorimin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë" ka ndërmarrë këtë vit iniciativën e hartimit të raportit të përditësuar mbi implementimin e ligjit "Për Rininë" të titulluar "Implementimi i Ligjit për Rininë: Perceptimi i të Rinjve dhe Oshc-ve". Qëllimi kryesor i këtij raporti është përditësimi i të dhënave të raportit të mëparshëm mbi ecurinë e implementimit të ligjit në nivel lokal e qendror, si dhe pasurimi i tij me elementë të tjerë duke integruar edhe perceptimet e aktorëve të tjerë social që preken në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ky proces siç janë organizatat e shoqërisë civile me fokus tek organizatat rinore dhe vetë të rinjtë. Këto evidencime pasqyrohen në mënyrë të dedikuar dhe strukturuar në këtë raport duke evidentuar problematikat dhe rekomandimet që ata kanë për aktorët e përfshirë në hartimin dhe implementimin e këtij ligji.

Nëpërmjet këtij raporti, synojmë të kontribuojmë dhe ti vijmë në ndihmë jo vetëm sektorit të shoqërisë civile, por edhe institucioneve publike, nivelit akademik dhe ekspertëve të sektorit rinor dhe gjithë aktorëve që operojnë në sektorin e politikave publike, mirëqeverisjes, transparencës dhe llogaridhënies si dhe dialogut të strukturuar midis institucioneve dhe aktorëve social në Shqipëri. Në nivel makro, ky raport shërben si një bazë të dhënash për të pasuaruar argumentimin shkencor mbi ndryshimet dhe nderhyrjet që duhen bërë për përmirësimin e sektorit rinor në vendin tonë.

# LISTA E SHKURTIMEVE

<b>AKR</b>	Agjencia Kombëtare e Rinisë
<b>AKSHI</b>	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
<b>INSTAT</b>	Instituti i Statistikave në Republikën e Shqipërisë
<b>KKR</b>	Këshilli Kombëtar Rinor
<b>KRK</b>	Kongresi Rinor Kombëtar
<b>KVR</b>	Këshillat Vendor Rinor
<b>MSHRF</b>	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
<b>NEET</b>	Jo në punësim, arsim apo trajnim
<b>OKPR</b>	Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore
<b>OSHC</b>	Organizatat e Shoqërisë Civile
<b>RER</b>	Regjistri Elektronik për Rininë
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave



# LISTA E FIGURAVE

**Figura 1:** Analiza SWOT e Këshillit Kombëtar Rinor

**Figura 2:** Vlerësimi i Specialistëve të Rinisë mbi Nenin 7 të Ligjit 75/2019

**Figura 3:** Ekzistenca e një manuali procedurash për ngritjen e KVR-ve

**Figura 4:** Parimet e zbatuara në ngritjen e KVR-ve

**Figura 5:** Niveli i ekspertizës së bashkive në hartimin dhe ngritjen e strukturave rinore

**Figura 6:** Ekzistenca e një plani/dokumenti strategjik për rininë në nivel vendor

**Figura 7:** Nevojat imediate të të rinjve në nivel lokal

**Figura 8:** Ekzistenca e një personi përgjegjës apo një specialisti për çështjet rinore

**Figura 9:** Ekzistenca e një databaze të OSHC-ve në nivel lokal

**Figura 10:** Perceptimi i bashkive mbi suportin e OSHC-ve për databazën lokale

**Figura 11:** Perceptimi i bashkive mbi rolin e aktorëve kryesorë në ofrimin e shërbimeve për të rinjtë në nivel lokal

**Figura 12:** Niveli i informimit të OSCH-ve mbi kompetencat e AKR

**Figura 13:** Niveli i informimit të OSCH-ve mbi Regjistrin Elektronik për Rininë

**Figura 14:** Niveli i informimit të OSCH-ve mbi Organizatën Përfaqësuese Rinore

**Figura 15:** Opinioni i OSHC-ve mbi ekzistencën e MSHRF

**Figura 16:** Opinioni i OSHC-ve mbi zhvillimet e sektorit rinor 2019-2022

**Figura 17:** Opinioni i OSHC-ve mbi Strategjinë e Rinisë 2022-2029

**Figura 18:** Perceptimi i OSHC-ve mbi ekzistencën e AKR

**Figura 19:** Perceptimi i OSHC-ve mbi KKR

**Figura 20:** Perceptimi i OSHC-ve mbi kapacitetet e KKR

**Figura 21:** Perceptimi i OSHC-ve mbi qartësinë e dispozitave ligjore lidhur me OKP

**Figura 22:** Perceptimi i OSHC-ve mbi procesin e themelimit të KVR

**Figura 23:** Perceptimi i OSHC-ve mbi kapacitetet e Bashkive për mbështetjen e KVR

**Figura 24:** Perceptimi i të rinjve mbi zhvillimet rinore 2019-2022

**Figura 25:** Vlerësimi i të Rinjve mbi rolin/funksionin e Ministrit të shtetit për rininë dhe Fëmijët

# TABELA E PËRMBAJTJES

<b>PARATHËNIE</b>	<b>2</b>
<b>LISTA E SHKURTIMEVE</b>	<b>3</b>
<b>LISTA E FIGURAVE</b>	<b>4</b>
<b>TABELA E PËRMBAJTJES</b>	<b>5</b>
<b>METODOLOGJIA</b>	<b>6</b>
<b>KAPITULLI 1: IMPLEMENTIMI I LIGJIT PËR RININË</b>	<b>8</b>
1.1 Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët	8
1.2 Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR)	10
1.3 Regjistri Elektronik për Rininë (RER)	11
1.4 Këshilli Kombëtar Rinor	12
1.5 Organizata Përfaqësuese Rinore	15
<b>KAPITULLI 2: IMPLEMENTIMI I LIGJIT TË RINISË NË NIVEL LOKAL</b>	<b>15</b>
<b>KAPITULLI 3: PERCEPTIMI I OSHC-VE MBI IMPLEMENTIMIN E LIGJIT PËR RININË</b>	<b>25</b>
<b>KAPITULLI 4: PERCEPTIMI I TË RINJVE MBI IMPLEMENTIMIN E LIGJIT 75/2019 "PËR RININË"</b>	<b>37</b>
<b>KAPITULLI 5: IMPLEMENTIMI I LIGJIT PËR RININË DHE E ARDHMJIA, SFIDAT DHE MUNDËSITË</b>	<b>45</b>
5.1 SFIDAT	48
5.2 MUNDËSITË	51
A. Rekomandime për rritjen e performancës së MSHRF në përputhje me Ligjin "75/2019"	51
B. Rekomandime për rritjen e performancës së AKR në përputhje me Ligjin "75/2019"	52
C. Rekomandime për rritjen e performancës së KKR në përputhje me Ligjin "75/2019"	52
D. Rekomandime për rritjen e performancës së Bashkive në përputhje me Ligjin "75/2019"	53
E. Rekomandime për OSCH-të lidhur me implementimin e Ligjit "75/2019"	53
F. Rekomandime të tjera	54
<b>KAPITULLI 6. ANEKSET</b>	<b>55</b>

# METODOLOGJIA

**“Implementimi i Ligjit për Rininë: Perceptimi i të Rinjve dhe Oshc-ve”** është një raport i cili bazohet në **metodologjinë mikse** të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave. Ky raport është konceptuar dhe hartuar në **katër faza kryesore** dhe përmban **të dhëna sasiore dhe cilësore** të përditësuara lidhur me **Ligjin 75/2019 “Për Rininë”**. Metoda mikse është zgjedhur nga ekspertët e këtij raporti si metoda shkencore me adeguate lidhur me qëllimin dhe objektivat e këtij studimi, duke qene se në mënyrë të mëvetësishme secila metodologji shkencore paraqet limitime studimore.

**FAZA E PARË** e hartimit të këtij raporti lidhet me **kampionimin, identifikimin dhe hartëzimin** e aktorëve kyç të cilët janë jo vetëm objekt i vëzhgimit dhe monitorimit nga ana e Kongresit Rinor Kombëtar por janë edhe kontribuesit kryesorë të gjetjeve dhe rekomandimeve që janë përfshirë në këtë studim. Duke qenë se ky raport përfshin një sërë çështjesh dhe zhvillimesh që lidhen me implementimin e Ligjit “Për Rininë” në nivele të ndryshme, edhe **kampioni i këtij studimi është ndarë në disa kategori**. Me qëllim përditësimin e kuadrit të përgjithshëm mbi Ligjin “Për Rininë” dhe **zhvillimet e tij në nivel qendror** ekspertët kanë identifikuar si kampion kryesor, **Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Agjencinë Kombëtare të Rinisë dhe anëtarët e Këshillit Kombëtar Rinor**. Për përditësimin e të dhënave dhe analizës së thelluar të implementimit të ligjit në nivel lokal, kampioni i përfshirë përbëhet nga përfaqësues të **61 bashkive të vendit**. Të dy këto kampione janë përzgjedhur nga ekspertet e këtij raporti nëpërmjet metodës jo-probabilitare duke përdorur teknikën e zgjedhjes së qëllimshme, pas një analize dhe vlerësimi të aktorëve kyç të përfshirë në hartimin dhe implementimin e ligjit 75/2019 “Për Rininë”.

**Një tjetër kampion** i përfshirë në këtë studim përbëhet nga **organizatat rinore**. Me qëllim identifikimin e problematikave, perceptimeve dhe rekomandimeve kryesore, një sërë aktorësh të shoqërisë civile janë bërë pjesë e këtij studimi duke dhënë kontributin e tyre jo vetëm nëpërmjet një pyetësoni online, por edhe nëpërmjet një fokus grupi të dedikuar me qëllim marrjen e inputit cilësor dhe diskutimin më të thelluar të çështjes. Ky kampion është zgjedhur nëpërmjet metodës së kampionimit probabilitar duke u fokusuar në atë rastësor të stratifikuar, duke përzgjedhur përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile, organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë në 12 qarqe të vendit.

**Kampioni i fundit** i përfshirë në këtë studim përbëhet nga **të rinjtë e moshës 15-29 vjeç** sipas përkufizimit të Ligjit Për Rininë. Ky kampion është përzgjedhur nëpërmjet metodës së kampionimit probabilitar duke përdorur teknikën e kampionimi të thjeshtë rastësor. Qëllimi i përfshirjes së këtij kampioni është jo vetëm matja e nivelit të informimit të tyre lidhur me Ligjin për Rininë por edhe përfshirja dhe analiza e perceptimit të tyre lidhur me strukturat që parashikon ky ligj si dhe detyrat/përgjegjësitë që çdo aktor duhet të përmbushë lidhur me nenet respektive.

Metodat e përdorura të kampionimit si dhe diversifikimi i aktorëve të përfshirë janë një vlerë e shtuar pasi përforcojnë konkluzionet dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë raport.

**FAZA E DYTË** bazohet tek rishikimi i literaturës ekzistuese, kërkimi paraprak dhe vlerësimi i dokumentave apo njoftimeve publike nga burime dytësore dhe komplementare si Vendime të Këshillit të Ministrave, njoftime në faqet zyrtare të institucioneve, postime në rrjete sociale ose kanale të tjera të medias si dhe deklarata për shtyp.

**FAZA E TRETË** e metodologjisë së përdorur për hartimin e këtij raporti lidhet kryesisht me procesin e mbledhjes së të dhënave. Për këtë arsye janë përdorur një sërë metodash për gjenerimin e të dhënave sasiore dhe cilësore si intervistat gjysëm të strukturuar, fokus grupe, pyetësorë online dhe kërkesa për informacion kryesisht ndaj institucioneve publike. Përzgjedhja e secilës metodë është bërë në varësi të kampionit të studimit me qëllim diversifikimin e aktorëve dhe përforcimin e gjetjeve dhe rekomandimeve që janë përfshirë në këtë raport.

**FAZA E KATËRT** e metodologjisë përfshin përpunimin dhe analizimin e të dhënave dhe draftimin e raportit.

## **TË DHËNAT DEMOGRAFIKE TË KAMPIONEVE**


Të dhënat e përfshira në këtë raport përfshijnë një sërë aktorësh të cilët kanë kontribuar në analizën, gjetjet dhe rekomandimet kryesore të përfshira në këtë studim.

Në analizimin e funksionimit të Këshillit Kombëtar Rinor, vetëm 7 nga 14 antarë që ka aktualisht kjo strukturë, kanë pranuar të bëhen pjesë e studimit dhe të zhvillojnë intervistat gjysëm të strukturuar të cilat janë zhvilluar online, pas dakordësimit të palëve. Këto intervista janë zhvilluar në periudhën Shtator-Tetor 2022.

Në përditësimin e të dhënave mbi implementimin e Ligjit të Rinisë 75/2019; 34 nga 61 bashkitë e vendit i janë përgjigjur pyetësorit që është hartuar nga ekspertët, pra rreth 56% e tyre.

Në analizën mbi perceptimin e organizatave rinore, janë përfshirë në total 51 organizata në rang kombëtar të cilat kanë shtrirje të gjere gjeografike dhe punojnë intensivisht në sektorin rinor në nivel lokal e kombëtar. Në mbledhjen dhe gjenerimin e të dhënave është përdorur metoda mikse duke përdorur si instrument kryesorë një pyetësor elektronik dhe një fokus grup të dedikuar.

Ndërkohë, pjesë shumë e rëndësishme e këtij studimi janë edhe vetë të rinjtë, perceptimet e të cilëve janë përmbledhur nëpërmjet një pyetësori elektronik. Kampioni i tyre përbëhet nga 180 të rinj të grupmoshës 15-29 vjeç të shtrirë në 12 qarqet e Shqipërisë.



## KAPITULLI 1: IMPLEMENTIMI I LIGJIT PËR RININË

### 1.1 Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Në shtator të vitit 2021, me fillimin e mandatit të qeverisë "Rama 3" pati një ristrukturim të disa minsitrive ku ndër të tjera u krijua Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në krye të së cilës u emërua Znj. Bora Muzhaqi, ish kandidatë për deputete e Partisë Socialiste në zgjedhjet e 25 prillit dhe ish zëvendësminsitre në ish ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për periudhën tranzitore Maj – Shtator 2021.

Kjo Ministri, edhe pse pa portofol, mori kompetencat e fushës së rinisë të cilat deri në këtë moment i ushtronte Minsitria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke udhëhequr edhe zbatimin e detyrimeve të parashikuara nga ligjit për rininë, së bashku me AKR-në.<sup>1</sup>

#### STRATEGJIA KOMBËTARE E RINISË 2022 - 2029



Me nisjen e mandatit Ministria e Rinisë u fokusua tek hartimi dhe konsultimi i Strategjisë së Rinisë si dokumenti kryesor i politikave që do të prijë në drejtimin e këtij sektori. Procesi i konsultimit për Strategjinë Kombëtare të Rinisë sipas Ministrisë përfshiu 1100 të rinj nga 68 gjimnaze e universitete të 22 bashkive të Shqipërisë.

Gjithashtu konsultimi i strategjisë u realizua edhe me organizatat rinore, për të rinjtë dhe shoqatat e grupet joformale, si dhe me Këshillin Kombëtar Rinor.

Sipas Minsitrisë së Rinisë pjesëmarrëse në konsultim ishin 41 organizata që veprojnë në rrethe të ndryshme të Shqipërisë. Strategjia u finalizua në formën e draftit në muajin mars 2022 dhe shtyllat kryesore të saj janë fuqizimi dhe pjesëmarrja rinore, autonomia dhe barazia rinore, si dhe mirëqenia sociale. Aspektet tjera të Strategjisë si inovacioni dhe edukimi cilësor, përfshirja sociale, qeverisja dhe administrimi i politikave rinore.



Pavarësisht se Strategjia e Rinisë duhet të kishte nisur implementimin në vitin 2022 ajo është miratuar prej Këshillit të Ministrave vetëm në muajin dhejtor 2022 ku pritet edhe buxhetimi i saj për vitin 2023. Sipas strategjisë pritet një rritje disafish e buxhetit për rininë nga 0,3% e GDP në 2,5%, shifër e cila shkon në të njëjtin nivel me sektorin e arsimit.<sup>2</sup>

Kostot totale të parashikuara për zbatimin e SKR 2022 - 2029 arrijnë në shumën 5,570,086, 793lekë, ndërkohë që buxheti i miratuar për rininë si zë buxhetor për Agjencinë Kombëtare të rinisë për vitin 2023 është 161,370,000 lekë, pra 7 herë më i ulët nga targeti i përcaktuar në vetë strategjinë e rinisë.

Politika kombëtare e strategjisë së rinisë dhe përpjekjet programuese përqendrohen në sigurimin e barazisë së mundësive dhe të drejtave, mbështetjes dhe angazhimit për të rejtat dhe të rinjtë që janë më të prekshëm, të marginalizuar dhe më të goditur nga mungesat e shumta, të tilla si varfëria, dhuna, keqtrajtimi, paaftësia dhe përjashtimi social.

Strategjia e Rinisë do të shoqërohet edhe me planin e saj të veprimit i cili do të detajojë edhe zbatimin në kohë, afat edhe buxhet indikatorët dhe objektivat e saj.

## KLASAT SMART



Nisur nga mungesa e infrastrukturës digjitiale në shkolla dhe një raporti të ulët nxënës – kompjuter, në muaj maj 2022 Ministria e Rinisë nënshkroi një marrëveshje me Fondacionin Amerikano - Shqiptar për Zhvillim për pajisjen e 100 shkollave të ciklit fillor me laboratorë SMART me qëllim zhvillimin e programeve të kodimit që në klasën e parë.

Ky projekt pritet të nisë zbatimin në vitin shkollor 2022 – 2023. Sipas këtij projekti do të përfitojnë mbi 7000 nxënës të klasës së parë në 100 shkollat e përzgjedhura. Fondacioni ADDF ka bërë të mundur blerjen e 1600 pajisjeve të para për të nisur zbatimin i menjëhershëm për 100 shkollat e para.

Platforma e përzgjedhur mes shumë syresh është “CodeMonkey”, që sipas ekspertëve është ndër zgjidhjet më të mira dhe që do të përdoret për mësimin e lëndës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, në thelb të të cilës do të jetë të mësuarit përmes lojës.


## GARANCIA RINORE

Garancia Rinore pritet të jetë një program i dedikuar për të rinjtë që nuk janë në punësim, arsimim apo trajnim, duke synuar identifikimin dhe regjistrimin e tyre në një skemë, me qëllim dhënien e një ofertë punësimi, praktike profesionale, edukimi apo trajnimi brenda katër muajve nga data e regjistrimit.

Sipas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë garancia rinore do të ndihmojë në reduktimin e papunësisë tek të rinjtë duke i mbështetur me kurse trajnime, kualifikime dhe punësim, me qëllim aftësimin e të rinjve për tregun e punës.<sup>3</sup>


## PROGRAMI I GARANCISË RINORE

### SKEMAT MBËSHTETËSE



## PROGRAMI I GARANCISË RINORE

### HAPAT KRYESORË



#YouthGuarantee

Grupi Ndërinstitucional, i mbështetur nga Bashkimi European do të ndjekë në vijim hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Kombëtar të Garancisë Rinore, për tu finalizuar me fillimin e projektit në gjysmën e dytë të vitit 2022.

Fillimi i implementimit të këtij projekti pritet të jetë me interes jo vetëm për të parë efektin direkt tek të rinjtë por edhe dublimin e mundshëm dhe ndarjen e funksioneve mes garancisë rinore dhe zyrave të punës. KRK i është drejtuar Minsitrisë përgjegjëse për Rininë për ecurinë e këtij instrumenti në muajin tetor, por kjo ministri është shprehur se kjo politikë si edhe plani i veprimit për garancinë rinore janë përgjegjësi e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe jo kompetencë e tyre.

## 1.2 Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR)

Agjencia Kombëtare e Rinisë u krijua në 2 Shtator 2020 me Vendim të Këshillit të Ministrave duke zëvendësuar Shërbimin Kombëtar të Rinisë si strukturë qendrore përgjegjëse për rininë. Veprimtaria e AKR-së shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë duke organizuar përgjegjësitë funksionale me qëllim sigurimin e kushteve për mbështjetjen dhe nxitjen e veprimtarive rinore, zhvillimin e dialogut të strukturuar për të realizuar fuqizimin e pozitës së të rinjve në shoqëri, krijimin e mekanizmave për nxitjen e politikave rinore si dhe marrjen e vendimeve profesionale, cilësore e të pavarura, në përzgjedhjen e programeve dhe projekteve që kanë në fokus rininë shqiptare dhe rëndësinë e kësaj të fundit në shoqëri. Nëpërmjet fondit grant të dedikuar për rininë, AKR-ja financon projektet rinore të organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, apo njësitë e vetëqeverisjes vendore. Projektet rinore të financuara nga nëpërmjet thirrjes nr.1 ishin në total 16, 12 për organizatat rinore dhe 4 për bashkitë.

Financimet për bashkitë përfshinin kryesisht qendra rinore, biblioteka dhe qendra kulturore ndërsa financimet që u akorduan organizatave rinore ose për të rinjtë kishin në fokus punën edukuese dhe informuese me të rinjtë. 12 organizatat kanë përfituar në total 28 722 680 lek ndërsa 4 bashkitë kanë përfituar në total 19136851 lek, pra rreth 40% e fondit ka shkuar vetëm për 4 bashki.



Kongresi Rinor Kombëtar monitoroi thirrjen nr.1 dhe dërgoi rekomandimet përkatëse ndaj AKR lidhur me transparencën, procesin e vlerësimit dhe kohën e hapjes së thirrjeve. Lidhur me zhvillimet e implementimit të Ligjit "Për Rininë" në nivel vendor, Agjencia Kombëtare e Rinisë ka informuar zyrtarisht

Kongresin Rinor Kombëtar se ka krijuar dhe miratuar manualin për ngritjen e këshillave vendor rinorë, i cili shërben si udhërrefyes për bashkitë. Gjithashtu AKR shprehet nëpërmejt një kërkesë për informacion se deri në datën 4 nëntor 2022 janë ngritur 39 Këshilla Vendorë Rinorë, ndërsa 22 bashkitë e tjera janë në process ngritje të kësaj strukture.

## 1.3 Regjistri Elektronik për Rininë (RER)

Në 24 dhjetor 2021 doli vendimi i qeverise nr 883 për krijimin e bazës së të dhënave për rininë, si regjistër elektronik për rininë (RER). Agjencia Kombëtare e Rinisë do të administrojë RER-in dhe është dhënësi i informacionit, në kuptim të legjislacionit për bazat e të dhënave shtetërore. Të dhënat që do të përmbajë RER do të ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore.

### **Të dhëna parësore do të jenë:**

- Numri i aplikimit nga Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore, organizata rinore dhe për të rinjtë, në vend apo në diasporë, për regjistrim në RER.
- Numri i regjistrimit në RER të Organizatës Kombëtare Përfaqësuese Rinore, organizatave rinore dhe për të rinjtë, në vend apo në diasporë.
- Të dhëna për politikën rinore kombëtare, të miratuara në fushën e planifikimit strategjik rinor për politikën rinore vendore dhe ato europiane.

### **Të dhëna dytësore, të cilat do të konsiderohen edhe si informacion konfidencial janë:**

- Të dhënat e regjistrimit gjyqësor në lidhje me organizatat jofitimprurëse, për numrin dhe datën e regjistrimit të subjektit, llojin (formën e organizimit) e organizatës jofitimprurëse, emrin e subjektit, fushën e veprimtarisë dhe misionin e tij.
- Të dhënat e regjistrimit tregtar për datën e regjistrimit të subjektit, emrin e subjektit/shoqërisë tregtare, numrin unik të identifikimit të subjektit, llojin e shoqërisë tregtare (formën e organizimit të saj), fushën e veprimtarisë dhe misionin e tij/saj, statusin e tij.
- Të dhënat e regjistrave që lidhen me studime, analiza, vlerësime, vëzhgime dhe vlerësime të zbatimit të politikave rinore.
- Të dhënat e regjistrave që kanë të bëjnë me financimin e projekteve dhe veprimtarive rinore.



nga nxjerrja e VKM në faqen zyrtare të AKR nuk është publikuar asnjë e dhënë mbi RER.

Agjencia Komëbtare e Rinisë ka informuar Kongresin Rinor Kombëtar se aktualisht është ngritur grupi i punës për zbatimin e kësaj VKM-je dhe është duke negociuar me institucionet ndërverpuese për të përcaktuar termat e referencës drejtuar AKSHI-t.

## 1.4 Këshilli Kombëtar Rinor

Së bashku me Agjencinë Kombëtare të Rinisë, më hyrjen në fuqi të ligjit për rininë mori jetë edhe **Këshilli Kombëtar Rinor**, si organ këshillimor pranë ministrit për Rininë. Më 24 Mars 2021 u konstitua dhe përbërja e KKR me përbërjen e tij prej 14 anëtarësh, ku 8 janë nga organizatat e shoqërisë civile, 4 nga shkollat dhe universitetet dhe 2 nga qeverisja vendore.

Pas konstituimit të tij, pavarësisht rolit të rëndësishëm në propozimin dhe kontrollin e politikave rinore, pak ose aspak aktivitet publik është parë nga ky organ, i cili sipas ligjit qëndron pranë Minsitrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ndërsa aktualisht ndodhet në faqen zyrtar të AKR-së.

Në vazhdë të intervistave gjysëm të strukturuar që ekspertët e këtij studimi kanë zhvilluar me vetë anëtarët e KKR si pjesë e metodologjisë për mbledhjen e të dhënave, është bërë e mundur gjenerimi dhe integrimi i opinioneve që vetë ata kanë për implementimin e Ligjit të Rinisë. Pjesë e të dhënave është dhe zhvillimi i analizës SWOT, ky anëtarët që kanë zhvilluar intervistat kanë identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të Këshilli Kombëtar Rinor si dhe sfidat dhe mundësit që vijnë nga faktorë të jashtëm. Nga 14 anëtarë që janë pjesë e kësaj strukture, vetëm 7 prej tyre kanë pranuar të jenë pjesë e këtij raporti.

### **Kalimi i Kompetencave të Rinisë nga ish MASR tek MSHRF**

Deri në Nëntor 2022, që përkon edhe me përmbylljen e këtyre intervistave nga ekspertët, anëtarët e KKR shprehen se kalimi i kompetencave ka ndodhur në një kohë relativisht të shkurtës pas formimit të tyre e për pasojë kanë mundur të zhvillojnë vetëm mbledhjen e parë nën ombrellën e MASR. Megjithatë, edhe pse ky takim është zhvilluar në periudhën Tetor-Nëntor 2021, ata kanë evidentuar një shkelje të rregullores së brendshme duke qene se sipas tyre njoftimi u bë vetëm 1 ditë përpara nderkohë që rregullorja i parashikon njoftimet në një hark kohor prej 7 ditësh në avanc. Ata gjithashtu shprehen se për këtë çështje është vënë në dijeni sekretariati teknik pranë AKR.

Për më tepër, anëtarët e KKR deklarojnë se duke qene se MSHRF ka një fokus të dedikuar tek rinia, ata ndihen më komod për të ngritur problematikat dhe për të diskutuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë me Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Sipas tyre, ky i fundit ka krijuar një raport të hapur dhe korrekt në marrëdhënie me anëtarët e KKR.

### **Implementimi i Neni 9 mbi Këshillin Kombëtar të Rinisë**

Lidhur me **pikën a dhe b të këtij Neni**<sup>4</sup>, anëtarët e KKR shprehen se në mbledhjen e parë janë konsultuar për prioritetet e thirrjes së parë për projekt propozime nga AKR, ku diskutimi kryesor më shume se paraqitjen e politikave prioritare apo propozimin e programeve kryesore për rininë, është fokusuar në ndarjen e Loteve të kësaj thirrjeje. Sipas tyre, në përmbyllje të thirrjes së parë, atyre ju është mundësuar një përditësim mbi rezultatet e thirrjes, por nuk kanë pasur një përditësim mbi procesin. Për më tepër ata shprehen se, edhe pse gjatë 2022 AKR ka shpallur thirrjen e dyte për projekt propozime ata ende nuk kanë një raport vlerësimi mbi thirrjen e parë duke përfshirë edhe monitorimin e iniciativave që janë financuar nga kjo thirrje dhe rezultatet që ato kanë arritur.

Lidhur me **procesin e draftimit të Strategjisë Kombëtar për Rininë 2022-2027** ata shprehen se nuk kanë zhvilluar një takim të dedikuar për këtë çështje por kanë marr draftin në email dhe kanë pasur disa ditë kohë të japin komentet e tyre. Rreth 30% e anëtarëve shprehen se për shkak të kohës së shkurtër nuk kanë pasur mundësi të përthithin materialin në kohë dhe të dergojnë sugjerimet e tyre.

Sipas anëtarëve, KKR ka përmbushur detyrimin e saj për realizimin e mbledhjeve vjetore, ku anëtarët duhet që të zhvillojnë dy takime në vit. Sipas tyre, pikat e diskutimit në mbledhjet e realizuara kanë ardhur me propozim të ministrit përgjegjës për rininë. Edhe pse në rregulloren e brendshme agjenda e takimit mund të sugjerohet edhe nga vetë anëtarët e KKR, këta të fundit shprehen se deri në Nëntor 2022, kjo gjë nuk ka ndodhur.

### **Raporti midis anëtarëve**

Një tjetër pikë e diskutimit është përqëndruar në raportin që anëtarët e KKR kanë së brendshmi, duke qenë se pavarësisht se vijnë nga 3 subjekte të ndryshme (organizata të shoqërisë civile, universitete/këshilla studentorë dhe institucione të vetë qeverisjes lokale) ata përfaqësojnë interesat e të gjithë të rinjve të Shqipërisë të cilët përbëjnë një numër të konsiderueshëm të popullësisë totale të vendit.

Një konstatim që vjen nga vetë ata ka të bëjë me mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve të KKR. Ata shprehen se përveç mbledhjeve të organizuara nga politikëbërësit, nuk kanë pasur takime të brendshme mbi ndarjen e informacionit apo bashkërendimit të prioriteteve dhe rekomandimeve të tyre. Shkak për këtë sipas tyre është mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të KKR, të cilët janë që në momentin që janë zgjedhur me votë, e kanë të pa mundur të kenë unifikim midis tyre. Për më tepër ata shprehen se nuk kanë një strukturë të brendshme, ndarje rolesh apo kapacitete të mjaftueshme për të ushtruar rolin e tyre në mënyrë efikase.

Një tjetër çështje që ata ngrenë është se rregullorja e brendshme është hartuar/miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe nuk mund të ketë ndërhyrje apo ndryshime nga vetë anëtarët e KKR.

## **Mbi Kryetarin e KKR**

Sipas Nenit 9, pika 2, "Këshilli Kombëtar i Rinisë kryesohet nga ministri përgjegjës për rininë dhe ka në përbërje 14 deri në 16 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Rinisë emërohen me urdhër të ministrit përgjegjës për rininë".<sup>5</sup>

Kalimi i kompetencave ka sjellë me vetë edhe ndryshimin e kryetarit të KKR nga ish MASR tek MSHRF. Sipas anëtarëve koha e kalimit ishte shume e shkurtër pas krijimit të këtij organi, ndaj nuk mund të kenë një gjykim objektiv mbi funksionimin dhe ushtrimin e kompetencave midis 2 kryetareve.

Ajo që vihet re nga intervistat e kryera është fakti se ka një dyzim mbi perceptimin e anëtarëve të KKR, mbi rolin që kryetari i KKR ka sidomos me pavarësinë e këtij organi. Një pjesë e tyre e shohin këtë si një zhvillim pozitiv dhe gjykojnë se fakti që kryetar i KKR është njëherësh edhe MSHRF rrit peshën e rekomandimeve dhe konkluzioneve të secilës mbledhje si dhe është një shtysë për lobimin/advokimin e politikave rinore. Megjithatë ka një pjesë prej tyre që shprehen skeptik, dhe deklarojnë se në prag të periudhave elektorale, ky organ mund të jetë pre e politizimit dhe njëanshmërisë politike.

Ajo që anëtarët e KKR kanë arritur të zhvillojnë gjatë intervistave me ekspertët, ka të bëjë edhe me reflektimin mbi ekzistencën dhe funksionimin e brendshëm të kësajë strukture. Këto reflektime janë përmbledhur në formën e analizë SWOT e cila është paraqitur grafikisht në figurën më poshtë.





Figura 1: Analiza SWOT e Këshillit Kombëtar Rinor

## 1.5 Organizata Përfaqësuese Rinore

Një tjetër organ i cili duhet të krijohet dhe të operonte në fushën e rinisë është Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore e cila është një organizatë që themelohet, organizohet dhe funksionon në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse dhe e ushtron veprimtarinë në përputhje me statutin e saj. Pavarësisht se gjatë vitit 2021 u hap dy herë thirrja për të aplikuar dhe mundësuar krijimin e kësaj organizate, nuk pati interes nga aktorë shqiptarë për ta themeluar atë. Bazuar në diskutimet dhe grupet e fokusuara me aktorë të organizatave rinore, ata u shprehën se proceduralisht është shumë e vështirë të bashkojnë vullnetet e 60 organizatave rinore dhe praktikisht kompetencat dhe funksionet e saj nuk janë të qarta në ligjin për rininë.



## KAPITULLI 2: IMPLEMENTIMI I LIGJIT TË RINISË NË NIVEL LOKAL

Një ndër shtyllat kryesore të monitorimit i është kushtuar ecurisë së implementimit të Ligjit për Rininë në nivel lokal, duke marrë si kampion studimi 61 bashkitë e vendit. Këto të dhëna për herë të parë janë gjeneruar përgjatë vitit 2021 në raportin e monitorimit të titulluar **“Sfidat dhe Efektet e Zbatimit të Ligjit 75/2019”**<sup>1</sup> ku nga 61 bashki, 43 i janë përgjigjur pozitivisht formateve që janë përdorur në gjenerimin e të dhënave duke mbuluar kështu rreth 70% të bashkive në vendit.

Në ndryshim nga viti i kaluar, këtë vit duket se ka një rënie në nivelin e përfshirjes së bashkive pas inq 61 bashki janë përfshirë vetëm 34 prej tyre, duke e ulur nivelin e mbulimit në rreth 56% në krahasim me 70% që ishte vitin e kaluar.

Bashkitë që janë përfshirë në studim janë bashkia: Pogradec, Berat, Cërrik, Durrës, Tiranë, Gjirokastrë, Gramsh, Kavajë, Klos, Kolonjë, Lezhë, Lushnje, Mat, Përmet, Rrogozhinë, Selenicë, Shkodër, Skrapar, Vlorë, Belsh, Bulqizë, Delvinë, Fier, Fushë-Arrëz, Kamëz, Korçë, Kukës, Kuçovë, Libohovë, Maliq, Mirditë, Përrenjas, Tropojë dhe Finiq.

# A. IMPLEMENTIMI I LIGJIT 75/2019 “PËR RININË”

Të gjitha bashkitë që i janë përgjigjur kërkesave për informacion, shprehin se janë aktualisht duke vijuar me implementimin e Ligjit 75/2019 “Për Rininë”.

Në një shkallë vlerësimi nga 1-5 (ku 1=aspak, 5= plotësisht) mbi funksionet që parashikon neni 7 mbi për organet e vetë qeverisjes vendore, përfaqësues të rinisë në bashkitë respektive kanë vlerësuar me nota të larta (4-5) pothuaj të gjitha detyrimet e Ligjit që nga pasqyrimi dhe respektimi i të drejtave të të rinjve deri tek parashikimi i të rinjve në buxhetet lokale.<sup>2</sup>

Megjithatë ajo që vihet re është një kontradiktë midis këtij vlerësimi dhe të dhënave që ata vetë kanë deklaruar në seksionet pasardhëse mbi implementimin e ligjit, ku kapacitetet e bashkive të vogla ose atyre në zonat rurale janë shumë të limituara në përmbushjen me sukses të detyrimeve ligjore të parashikuara për bashkitë.

3. Në përmbushje të Nenit 7 mbi Njësitë e vetëqeverisjes vendore vlerësoni nga 1 tek 5 (1=aspak, 2=pak, 3=Disi, 4=Mjaftueshem dhe 5= plotësisht) sa i ka përmbushur bashkia juaj detyrimet ligjore që parashikon Ligji 75/2019 “Për Rininë”




Figura 2: Vlerësimi i Specialistëve të Rinisë mbi Nenin 7 të Ligjit 75/2019

## B. NGRITJA E KËSHILLAVE VENDORË RINOR

83% e bashkive të përfshira në këtë raport shprehin se e kanë ngritur Këshillin Vendor Rinor ndërkohë që 17% ende nuk kanë vijuar me këtë proces. 56% e tyre shprehin se kanë bashkëpunuar me organizatat e shoqërisë civile në ngritjen e tyre. Lidhur me sfidat kryesore që ata kanë hasur në këtë proces, institucionet e vetë qeverisjes lokale deklarojnë numrin dhe interesin e ulët të të rinjve për të marrë pjesë, kohëzgjatja e proceseve burokratike, angazhimi fiktiv i të rinjve, komunikimi dhe bashkërendimi në kohë me institucionet dhe aktorët që punojnë më rininë në mënyrë intensive si dhe niveli i ulët i ndërgjegjësimit mbi rëndësinë dhe mundësitë që ligji 75/2019 ofron për të rinjtë në nivel lokal.






Figura 3: Ekzistenca e një manuali procedurash për ngritjen e KVR-ve

përshtatur kete manual në kontekstin lokal duke krijuar kështu diferencime nga njëra bashki në tjetren. Nderkohë, rreth 27% e bashkive shprehen se ngritja e KVR-ve është lënë në dorë të lirë të secilit institucion në nivel lokal.



Figura 4: Parimet e zbatuara në ngritjen e KVR-ve

takime ne shkolla dhe gjimnaze për ti njoftuar mbi thirrjen si dhe thonë se kanë bashkëpunuar me OSHC-të në ato qytete ku ka prezencë të tyre.

Lidhur me përfshirjen e të rinjve nga grupet e marginalizuara, 50% e atyre që janë përfshirë në studim, deklarojnë se ka pasur përfshirje të të rinjve me të disavantazuar. Prej tyre, 33% shprehen se kanë përfshirë të rinj nga zonat rurale apo në vështirësi socio-ekonomike, 6% nga të rinjtë që vijnë nga komuniteti Rom dhe Egjiptian dhe 3% përfaqësues të qeverisë së nxënësve apo përfaqësi të tjera studentore. Nga ajo që bashkitë kanë deklaruar duket se nuk ka përfshirje të komunitetit LGBTQ+, të rinjve me aftësi ndryshe apo të rinjve të kategorisë NEET. Edhe pse në Nenin 10, pika 2<sup>3</sup> specifikohet qartësisht se *“Këshilli vendor i rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e këshillit vendor të rinisë emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë.”*; rreth 20% e bashkive që janë bërë pjesë e këtij studimi shprehen se KVR-të pranë institucioneve ku ata operojnë, kanë më shumë se 6 anëtarë. Megjithatë, nuk ka një specifikim nëse ata janë në nivel antarësie apo janë të emëruar nga vetë kryetari.

Lidhur me menyrën se si janë ngritur këto këshilla, të gjitha bashkitë shprehet se ngritja e tyre është bërë me vendim të këshillit bashkiak, megjithatë hapat e ndjekur në secilën bashki janë të ndryshme dhe periudha kohore ku janë miratuar këto vendime dhe janë vënë në zbatim është e ndryshme. Edhe pse rreth 70% e bashkive janë përgjigjur se ka një manual procedurash mbi ngritjen e KVR-ve, nga hapat që secila bashki ka deklaruar duket se secila prej tyre e ka

94% e bashkive shprehen se ngritja e KVR është zbatuar mbi parimin e transparencës, gjithëpërfshirjes dhe barazisë gjinore. Megjithatë, gjatë plotësimit të anëtarëve pjesa më e madhe e tyre, deklarojnë se vajzat provalojnë në krahasim me djemtë. Për të përmbushur parimin e transparencës dhe gjithëpërfshirjes, ata shprehen se përzgjedhja e anëtarëve të KVR-ve është bërë nëpërmjet thirrjeve publike ne faqet zyrtare të bashkive. Disa prej tyre shprehen se kanë zhvilluar edhe



Figura 5: Niveli i ekspertizës së bashkive në hartimin dhe ngritjen e strukturave rinore

Një tjetër pikë e rëndësishme e analizës së implementimit të Ligjit “Për Rininë” në nivel lokal ka të bëjë me nevojat që kanë bashkitë për të tejkaluar sfidat që kanë hasur gjatë ngritjes së KVR-ve. Edhe pse 53% e bashkive deklarojnë se kanë ekspertizën e duhur në hartimin dhe dizejnimin e strukturave rinore, sërish një pjesë e madhe e tyre (47%) e mohojnë këtë gjë. Ndër nevojat kryesore që ato deklarojnë përfshihen: forcimi i bashkepunimit midis organizatave të shoqërisë civile, sektorit publik dhe aktivistë

të çështjeve rinore; ngritja e kapaciteteve të stafit të bashkive lidhur me hartimin e politikave rinore dhe menaxhimin e strukturave rinore; ngritja e një sistemi informimi të përditësuar dhe të përshtatur me problematikat e të rinjve në nivel lokal mbi mundësitë që ofrojnë të gjithë aktorët që operojnë në sektorin rinor; përmirësimi i infrastrukturës rinore, hartimi i strategjive vendore për rininë si dhe mbështetje financiare nga institucionet qendrore kundrejt bashkive, sidomos ato që janë në zona më rurale.

## C.EKZISTENCA E NJË DOKUMENTI STRATEGJIK/ PLANI VEPRIMI DHE BUXHETI PËR IMPLEMENTIMIN E LIGJIT “PËR RININË”



Figura 6: Ekzistenca e një plani/dokumenti strategjik për rininë në nivel vendor

Duke qenë se Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 është miratuar së fundmi, lind nevoja e përkthimit dhe përshtatjes së këtij dokumenti edhe në nivel lokal për të siguruar kështu jo vetëm përfshirjen aktive të të rinjve në hartimin e politikave rinore, por edhe konceptimin e një sërë prioritetesh dhe masash për përmirësimin e sfidave madhore që të rinjtë hasin në secilën bashki. Megjithatë, vetë bashkitë e përfshira në këtë raport deklarojnë se nuk kanë një dokument strategjik në nivel lokal që identifikon dhe

adreson problematikat e të rinjve në zonat ku ato ushtrojnë funksionin e tyre. Më konkretisht 80% e tyre shprehen se nuk e disponojnë një dokument të tillë, ndërkohë që 20% e bashkive deklarojnë se e kanë një strategji për rininë në nivel lokal.

Ndër arsyt kryesore për mungesën e këtij dokumenti, bashkitë rendisin mungesën e personave të specializuar në hartimin e këtyre dokumentave; mungesën e fondeve, fleksibilitetin e ulët të organigramave të bashkive si dhe barrierat ligjore që bashkitë hasnin sidomos përpara aprovimit të Ligjit 75/2019 "Për Rininë.

Edhe përse pjesa më e madhe e bashkive nuk ka një strategji të qartë që përcakton problematikat e të rinjve në mënyre specifike, shume prej tyre arrijnë të identifikojnë fushat tematike ku të rinjtë hasin më shumë vështirësi. Sic mund të shihet edhe në paraqitjen grafike më poshtë 3 problematikat kryesore janë në fushën e punësimit, zhvillimit socio-kulturor dhe mungesën e hapsirave kreative dhe të sigurta për të rinjtë. Sipas tyre, këto nevoja reflektohen edhe në fushat prioritare ku duhet të bëhen ndërhyrjet në nivel të politikave publike




Figura 7: Nevojat imediate të të rinjve në nivel lokal

Një fakt interesant lidhur me procesin e hartimit të dokumentave strategjik në nivel lokal është se 92% e bashkive që janë pjesë e këtij raporti shprehen se bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile do t'i vinte në ndihmë këtij procesi. Vetëm 8% e tyre janë përgjigjur negativisht për këtë aspekt. Mungesa e një dokumenti strategjik në nivel lokal, rrjedhimisht sjell edhe mungesën e monitorimit dhe vlerësimit të punës që bëhet në sektorin rinor në secilën bashki. Rreth 70% e bashkive shprehen se nuk kanë një plan monitorimi dhe vlerësimi të programeve apo iniciativave rinore brenda institucionit të tyre.

Për më tepër, 56% e bashkive shprehen se nuk kanë një buxhet të dedikuar për rininë. Rreth 85% e tyre cilësojnë taksat vendore si burimin kryesor të të ardhurave në bashkinë e tyre, ndaj e rendisin këtë fakt ndër arsyt kryesore të pamjaftueshmërisë së fondeve në bashkitë respektive. Lidhur me mekanizmat ekzistues në nivel lokal që sigurojnë pjesëmarrjen e të rinjve në diskutimet mbi prioritetet e buxhetit në nivel lokal, rreth 80% e bashkive rendisin degjësat publike dhe buxhetimin me pjesëmarrje, nderkohë pjesa e mbetur deklarojnë mbledhjet e këshillit bashkiak, platformat online, takimet konsultuse tematike si dhe rrjetet sociale.

# D.EKZISTENCA E NJË PERSONI PËRGJEGJËS APO NJË SPECIALISTI PËR ÇËSHTJET RINORE




Figura 8: Ekzistenca e një personi përgjegjës apo një specialisti për çështjet rinore

94% e bashkive që janë bërë pjesë e raportit, shprehin se e kanë tashmë një person përgjegjës/specialist rinie në institucionin e tyre.

Megjithatë, ajo që vihet re është se vetëm 50% deklarojnë se ky person është i dedikuar për çështjet rinore ndërkohë që gjysma e mbetur shprehin se ky person është një specialist ekzistues të cilit i janë shtuar edhe kompetencat e rinisë.

Në këtë situatë vetë përfaqësuesit e bashkive kanë identifikuar nevojat kryesore lidhur me zhvillimin e kapaciteteve njerëzore me qëllim ofrimin e shërbimeve cilësore për të rinjtë e komuniteteve që ata përfaqësojnë.

Nevojat kryesore sipas tyre janë:

- Shtimi i stafit të kualifikuar në punën rinore dhe ofrimin e shërbimeve për të rinjtë
- Rritje e numrit të trajnimeve, programeve për rritjen e kapaciteteve të punonjësve aktual në hartimin dhe dizejnimin e politikave, programeve, aktiviteteve rinore
- Rritja e ekspertizës së brendshme ose të jashtme mbi hartimin e dokumentave strategjik në nivel lokal
- Shtimi ose përmirësimi i hapsirave dhe infrastrukturës rinore/artistike/kulturore në nivel lokal
- Shtimi i mundësive për rrjetëzim dhe shkëmbim eksperiencash me bashkitë simotra në rajon dhe Europë
- Shtim i burimeve financiare nga pushteti qendror në atë lokal për sektorin rinor

## E. EKZISTENCA E NJË DATABAZE TË ORGANIZATAVE LOKALE



Figura 9: Ekzistenca e një databaze të OSHC-ve në nivel lokal

Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave, i është kushtuar vëmendje edhe ekzistencës së një databaze të organizatave lokale nga ana e bashkive. Në fakt, 62% e bashkive që janë bërë pjesë e raportit, shprehen se e disponojnë një të tillë ndryshë nga 38% e tyre të cilët e mohojnë ekzistencën e saj.

Megjithëate, nga ata që shprehen se e disponojnë vetëm 52% deklarojnë se kjo databazë është publike.

Sfidat kryesore që vetë përfaqësuesit e bashkive kanë identifikuar lidhur me krijimin e kësaj databaze janë:

- Ekspertizë e brendshme/e jashtme e ulët për gjenerimin e metodologjisë lidhur me hartimin dhe krijimin e databazës
- Mungesa e një modeli/plani/dokumenti strategjik në nivel lokal & kombëtar që udhëzon gjenerimin dhe mbledhjen e të dhënave në sektorin rinor duke përfshirë dhe organizatat lokale
- Mungesë kapacitetesh njerëzore dhe financiare për krijimin dhe mirëmbajtjen e një databaze të tillë
- Mungesë organizatash lokale që operojnë në sektorin rinor (në bashkitë e vogla)

Në vijim përfaqësuesit e bashkive janë pyetur mbi nevojat kryesore që ata kanë në gjenerimin dhe mbledhjen e të dhënave. Deri përpara miratimit të Ligjit të Rinisë, ata shprehen se rinia nuk ka qenë një kompetencë e bashkisë, ndaj nuk ka pasur arsye specifike për ekzistencën e këtyre të dhënave.

Pas miratimit të këtij ligji, nevojat kryesore lidhur me këtë pikë janë:

- Diferencimi i të dhënave për rininë nga të dhënat e tjera që gjenerohen në nivel lokal
- Shtimi i stafit përgjegjës për rininë me persona të kualifikuar në hartimin, gjenerimin dhe analizimin e këtyre të dhënave

- Ekspertizë në hartimin e metodologjisë dhe instrumentave në mbledhjen e të dhënave
- Nxitja dhe intensifikimi i dialogut dhe bashkëpunimit me Drejtorinë e Pergjithshme të Gjendjes Civile dhe INSTAT
- Krijimi i një ekupi lokal të aftësuar për mbledhjen e të dhënave për rininë të terren
- Gjenerimi i të dhënave të unifikuara për aktorët të cilët operojnë në fushë e rinisë (OJF, Institucione lokale/qëndrore)
- Suport logjistik jo vetëm në metodologjinë e krijimit dhe mbledhjes së të dhënave, por edhe aspektit teknik dhe digjital që do të mundësojë përditësimin e tyre dhe publikimin e tyre në faqet zyrtare të bashkive



Figura 10: Perceptimi i bashkive mbi suportin e OSHC-ve për databazën lokale

Nga ana tjetër, 88% e bashkive gjykojnë se ekzistenca e një database të tillë do ta fasilite punën e tyre dhe bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile në të ardhmen. Madje 94% e tyre gjykojnë se organizatat e shoqërisë civile mund ti vijnë në ndihmë bashkive në krijimin dhe mirëmbajtjen e një database te tillë.

## F. QASJA E BASHKISË NDAJ TË RINJVE: PROGRAMET DHE INICIATIVAT


Një tjetër aspekt që është marrë në konsideratë dhe është reflektuar në këtë raport, është qasja që bashkitë kanë kundrejt të rinjve. 95% e bashkive shprehen se rinia është në fokus të punës së tyre. Megjithatë, shumë më pak prej tyre mund të japin shembuj se ku konkretisht reflektohet ky prioritet në nivel lokal dhe në punën e tyre të përditshme. Ajo që vihet re, ngjashëm me gjetjet e raportit të parë **“Sfidat dhe Efektet e Zbatimit të Ligjit 75/2019”** bashkitë të cilat kanë mungesë të infrastrukturës apo kapaciteteve për krijimin e programeve dhe aktiviteteve rinore, vijojnë të cilësojnë si rinore të gjitha eventet që prekin kulturën, arsimin, mjedisin, integrimin European apo fusha të tjera të cilat e kanë rininë pjesë të përfituesve të tyre.

Një shembull pozitiv që mund të theksojmë në këtë pikë, lidhet me **Bashkinë Gramsh**. Sipas tyre, bazuar në Planin Social të Bashkisë Gramsh (2021-2023), çdo vit 5 të rinj të sapodiplomuar, kryesisht të familjeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, punësohen për gjashtë muaj sipas profesionit që kanë në biznese lokale apo në Bashkinë Gramsh. Bashkia financon pagat e tyre në masën 26.000 lekë/ muaj.

Gjithashtu, **Bashkia Korçë** shprehet se ka në vizionin e saj përgatitjen e të rinjve drejt tregut global në fushën e programimit, teknologjisë dhe inovacionit. Nëpërmjet qendrës së teknologjisë dhe inovacionit të rinjtë në qytetin e Korçës dhe bashkitë për rreth kanë mundësi të anagazhohen në aktivitete apo konkurse që lidhen me zhvillimin e aftësivetë tyre në këtë sektor.

Një tjetër rast suksesi na paraqitet nga **Bashkia Klos**. Ata shprehen se janë përfitues të thirrjes për projekt propozime nga AKR dhe shumë shpejt pritet të fillojë puna për ngritjen e një qendre rinore në bashkinë e tyre.

Pavarësisht qasjes pozitive, bashkitë shprehen se kanë kapacitete të kufizuara njerëzore, financiare, logjistike dhe digjitale për të pasur një mirefunksionim dhe përmirësim të dukshëm në sektorin e rinisë në nivel lokal. Barrierat që ata hasin në këtë aspekt lidhen ngushtimisht me përmirësimin e infrastrukturës rinore, kulturore dhe artistike në bashkitë respektive; mungesën e mbështetjes financiare nga pushteti qëndror në atë lokal si dhe vështirësi në gjetjen dhe rekrutimin e stafit të kualifikuar në sektorin rinor dhe punën me të rinjtë.



**Figura 10:** Perceptimi i bashkive mbi rolin e aktorëve kryesorë në ofrimin e shërbimeve për të rinjtë në nivel lokal

Sipas bashkive, 62% deklarojnë se rolin kryesor në mbështetjen e bashkive për ofrimin e shërbimeve dhe hartimin e politikave rinore në nivel lokal e ka Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Kjo shifer ka një diferencë të dukshme lidhur me aktorët e tjerë, pasi 18% e bashkive thonë se këtë rol kryesor duhet ta luajë AKR, dhe 12% e tyre ja adresojnë organizatave të shoqërisë civile.

Shumë më pak prej tyre ja adresojnë komunitetit të biznesit (3%); Qeverisë (3%) dhe vetëm 2% thone se këtë rol duhet ta luajnë të gjithë aktorët së bashku.

## G. ROLI I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË NIVEL LOKAL

Ngjashëm me raportin e vitit të kaluar, bashkitë shprehen se roli i organizatave rinore në nivel lokal është shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për përmirësimin e sektorit rinor në bashkitë respektive. Ata gjykojnë se përgjithësisht kanë pasur raporte të mira me organizatat e shoqërisë civile (në bashkitë ku ato ekzistojnë ose ku operojnë) dhe se nëpërmjet tyre kanë arritur të zhvillojnë disa aktivitete apo iniciativa të cilat nuk arrijnë ti zhvillojnë në kuadër të bashkisë për shkak të kapaciteteve të limitura që janë paraqitur me detaje në seksionet pararendëse.


Bashkia Shkodër, Durrës dhe Selenicë shprehen se kanë bashkëpunime të vazhdueshme me organizatat e shoqërisë civile dhe e gjykojnë më shumë rëndësi rolin e tyre në mbështetjen e bashkive respektive në përmbushjen e objektivave lokal lidhur me rininë në komunitetet e tyre.

Në këtë linjë, përveç problematikave kemi evidentuar edhe nevojat kryesore që bashkitë kanë për të siguruar një bashkëpunim më të mirë me organizatat e shoqërisë civile në bashkitë respektive.

Sipas tyre nevojat kryesore janë:

- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me OJF rinore/për të rinjtë
- Krijimi një dokument strategjik që do të fasilitojë bashkëpunimin dhe punën me OSHC-të
- Konceptimi/Hartimi/Implementimi i një skeme grantesh që i vjen në ndihmë OSHC-ve dhe zhvillimit të iniciativave rinore në nivel lokal
- Nxitja e dialogut dhe bashkëpunimit në ngushtë midis OSCH-ve dhe Bashkive për aplikime të ndryshme në projekt propozime
- Nxitja e dialogut dhe bashkëpunimit me organizata kombëtare, rajonale dhe Europiane me qëllim rrjetëzimin, shkëmbimin e eksperiencave dhe krijimin e partneriteteve të reja në fushën e rinisë





## KAPITULLI 3: PERCEPTIMI I OSHC-VE MBI IMPLEMENTIMIN E LIGJIT PËR RININË

Në raportin “Sfidat dhe Efektet e Zbatimit të Ligjit 75/2019 ‘Për Rininë’”, Kongresi Rinor Kombëtar ka identifikuar disa çështje të cilat janë diskutuar me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile më aktive në rrethet dhe në Tiranë gjatë një fokus grupi të dedikuar Ligjit për Rininë. Nga ky fokus grup janë identifikuar një sërë problematikash dhe shqetësimet kryesore që organizatat rinore dhe për të rinjtë kanë ngritur lidhur me implementimin e ligjit. Këto shqetësime lidhen kryesisht me procesin e ngadaltë dhe paqartësitë lidhur me procesin e implementimit të ligjit, mungesën e transparencës nga organet ligjzbatuese dhe si dhe riskun e politizimit dhe njëanshmërinë e strukturave të cilat janë në një farë mënyre produkt i këtij ligji.

Gjetjet në këtë kapitull përfshijnë jo vetëm perceptimin e OSHC-ve mbi implementimin e ligjit por edhe rekomandimet që ata kanë adresuar për përmirësimin e situatës, duke qenë se viti 2022 përkon edhe me periudhën e maturimit të ligjit.

### A. NIVELI I INFORMIMIT MBI LIGJIN 75/2019 “PËR RININË”

95 % e organizatave shprehen se kanë informacion mbi Ligjin për Rininë, duke konstatuar se niveli i informimit është reaktivisht i lartë. Lidhur me burimin e këtij informacioni, 33% e organizatave shprehen se janë informuar mbi ligjin nga faqet e institucioneve, 19% e tyre nga faqet zyrtare të organizatave jofitimprurëse dhe 14% thonë nëpërmjet rrjeteve sociale të organizatave rinore/për rininë, duke nxjerrë në pah edhe kontributin e vetë organizatave në përhapjen e informacionit mbi këtë ligj. Pjesa tjetër kanë rënë në kontakt me ligjin nëpërmjet medias vizive ose të shkruar (14%) por edhe nga vetë Kongresi Rinor Komëbtar (5%).

Për të kuptuar më shumë mbi nivelin e informacionit të organizatave mbi kompetencat që parashikon ligji për organet dhe vetë sektorin, atyre u janë drejtuar pyetje të drejtëpërdrejta. 81% e organizatave të përgjigjura janë në dijeni të ndryshimeve që sjell ligji për sektorin e rinisë dhe po kaq janë në dijeni të kompetencave që ligji i ngarkon Këshillit Komëbtar të Rinisë, ndërsa 19% e tyre nuk e kanë këtë informacion shtesë.




Figura 12: Niveli i informimit të OSCH-ve mbi kompetencat e AKR

Organizatave njohin më shumë kompetencat e AKR (86%) sesa të Minsitrisë përgjegjëse për rininë (76 %). Ky element mund të jetë si pasojë e krijimit të mëvonshëm të një minsitrie të posaçmë për rininë apo edhe për faktin se organizatat kanë një marrdhënie të drejtpërdrejtë me AKR për shkak të procesit të aplikimit për projekte në thirrjet e saj. Ndërkohë kemi një nivel shumë të lartë informacioni mbi kompetencat e Këshillave Vendorë Rinorë, ku 91 % e organizatave i

i njohin kompetencat e tyre. Kjo për faktin se puna e tyre e përditshme në nivel lokal lidhet me ngritjen dhe funksionimin e këtyre strukturave. Nga ana tjetër një nivel më i ulët informacioni paraqitet për dy komponentë të rëndësishëm të ligjit si Regjistri Elektronik për Rininë (57 %) dhe Organizata Kombëtare Rinore Përfaqësuese (68 %). Ky nivel më i ulët informacioni mund të lidhet me faktin se këto dy instrumenta ende nuk janë bërë të prekshme për komunitetin e organizatave dhe interesi për to ka qënë i ulët.




Figura 13: Niveli i informimit të OSCH-ve mbi Regjistrin Elektronik për Rininë




Figura 14: Niveli i informimit të OSCH-ve mbi Organizatën Përfaqësuese Rinore

## B. PERCEPTIMI I ORGANIZATAVE RINORE PËR IMPLEMENTIMIN E LIGJIT TË RINISË NË NIVEL QËNDROR

### Perceptimi i OSHC-ve mbi Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijet dhe Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029

**86 % e organizatave rinore shprehen se një ministër shteti i dedikuar për rininë rrit vëmëndjen ndaj të rinjve në nivel institucional.**



Figura 15: Opinioni i OSHC-ve mbi ekzistencën e MSHRF

Përfaqësuesit e organizatave e lidhin këtë argument me faktin se një ministri e dedikuar do të jetë pjesë e Këshillit të Ministrave duke shtyrë politikat rinore, do të jetë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të rinisë dhe do të advokojë për një buxhet më të lartë për sektroin e rinisë dhe do të jetë një organ garant për zbatimin e ligjit për rininë. Ndërkohë 14% e organizatave janë skeptike për këtë dhe shprehen se kësaj minsitrie i mungojnë kompetencat reale dhe vendimet që merren janë politike e jo teknike.

60% e organizatave thone se nuk janë ftuar të marrin pjesë në takimet e organizuara nga MSHRF duke u shprehur se nuk janë njoftuar për takime të tilla, ndërsa 40 % e tyre shprehen se kanë qënë te ftuara në aktivitete, takime konsultative ose informuese te organizuara nga MSHRF. Megjithatë, 73% e tyre thone se janë në dijeni të procesit të hartimit dhe draftimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, por vetëm 28 % kanë mundur të marrin pjesë në takimet konsultative të organizuara nga MSHRF. Ndër arsyt kryesore sipas tyre, renditen mungesa e njoftimit dhe ftesave për të qënë pjesë në takim dhe shtrirja gjeografike e shumcës se aktviteteve, që sipas tyre jane realizuar kryesisht në Tiranë.

Gjatë diskutimeve të zhvilluara gjatë fokus grupit, rreth 47% e pjesëmarrësve thonë se përveç diskutimeve mbi tematikat prioritare ata kanë depozituar edhe një sërë rekomandimesh të cilat sipas tyre janë reflektuar dhe pasqyruar në draftin parafinal i cili u është dërguar në email përpara finalizimit të këtij dokumenti. Disa nga anëtarët prezent në takim, shprehen se janë përfshirë gjithashtu në mënyrë aktive gjatë konsultimit me të rinjtë i cili është zhvilluar në Korçë në data 19-20 Mars, ku kanë fasiltuar disa nga punët me grupe me qëllim prezantimin dhe diskutimin e prioriteteve dhe rekomandimeve të përfshira në draft strategjinë me të rinjtë.




Figura 16: Opinioni i OSHC-ve mbi zhvillimet e sektorit rinor 2019-2022

Sipas 73% të organizatave zhvillimet e 3 viteve të fundit e kanë përmirësuar situatën e organizatave rinore në vend, ndërsa 5% janë të mendimit se e kanë përkeqësuar situatën e tyre. 19% e organizatave shprehen se këto zhvillimet nuk kanë sjellë asnjë ndryshim në organizatat rinore, ndërsa 3% e tyre listojnë opsionin “tjetër” edhe pse nuk kanë dhënë specifikime të mëtejshme për këtë zgjedhje.

Megjithëate, në një shkallë nga 1 tek 5 (1=aspak, 5= plotësisht), organizatat rinore dhe për të rinjtë kanë një vlerësim të ulët deri në mesatar (3) për sa i përket përmbushjes së detyrimeve nga ana e MSHRF të parashikuar në nenin 7 të ligjit për rininë. Me nota më të larta (5) janë vlerësuar hartimi dhe monitorimi i zbatimit të politikave dhe me nota më të ulëta (1-2) janë vlerësuar monitorimi i standarteve për ndërtimin e hapësirave rinore.




Figura 17: Opinioni i OSHC-ve mbi Strategjinë e Rinisë 2022-2029

Në mënyrë absolute 95 % e organizatave të pyetura janë shprehur se ekzistenca e një strategjie për rininë i shërben atyre për të adresuar më mirë problematikat dhe për të gjetur zgjidhje më të mira për të rinjtë.

## Perceptimi i OSHC-ve lidhur me punën e AKR dhe implementimin e thirrjeve për projekt propozime

Agjencia Kombëtare e Rinisë është një ndër organet më të reja që është themeluar pas aprovimit të Ligjit 75/2019 “Për Rininë”.

**Bazuar në këtë ligj, në përmbushje të Nenit 8 ky organ duhet të ushtrojë funksionet dhe përgjegjësitë si më poshtë:**

- zbaton politikat dhe programet për të rinjtë;
- organizon, administron, financon, koordinon dhe monitoron e mbikëqyr programet dhe projektet rinore;
- bashkëpunon me organizma, institucione, donatorë dhe subjekte të tjera, vendase e të huaja, për prezantimin dhe zbatimin e politikave, programeve dhe veprimtarive rinore;

- mbështet ngritjen e kapaciteteve të njësisve dhe strukturave në nivel qendror dhe vendor;
- krijon dhe mirëmban bazën e aksesueshme të të dhënave për rininë; dh) siguron financime nëpërmjet aplikimit në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat transferohen mbi bazë vjetore në rastet kur miratohet një projekt shumëvjeçar;
- mbledh, administron dhe analizon të dhënat mbi situatën e të rinjve në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- raporton në mënyrë periodike pranë ministrisë përgjegjëse për rininë për situatën e të rinjve dhe zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ky ligj;
- mbikëqyr veprimtarinë rinore dhe të punës me të rinjtë nga organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, që përfitojnë mbështetje sipas parashikimeve të këtij ligji.




Figura 18: Perceptimi i OSHC-ve mbi ekzistencën e AKR

i pamjaftueshëm për të zgjidhur problematikat rinore ndërsa 24% nuk kanë ndonjë mendim mbi këtë çështje. 53 % e organizatave të përfshira në këtë anketim kanë aplikuar në thirrjen për aplikime të organizuar nga AKR, por vetëm 14% e tyre mendojnë se fondet e AKR janë përdorur në mënyrë eficiente. Pjesa tjetër janë skeptikë dhe të distancuar për të dhënë një opinion mbi këtë çështje. Disa prej organizatave janë shprehur mbi menaxhimin e thirrjes së AKR duke e cilësuar si një proces tepër burokratik dhe jo transparent në përzgjedhjen e fituesve, duke ulur edhe besimin e këtij instrumenti tek vetë organizatat aplikante.

Sipas perceptimit të OSHC-ve të përfshira në fokus grup, perceptimi publik i AKR duket se është zbehur ndjeshëm pas caktimit të Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ku sipas tyre duket se ky i fundit ka marrë vëmendjen më të madhe jo vetëm nga organizatat e shoqërisë civile por edhe nga media dhe aktorët e tjerë.

Një tjetër komponent lidhur me diskutimin mbi punën e AKR është edhe thirrja e parë për projekt propozime rinore. Shqetësimet e organizatave mbeten të njëjta si në raportin «Sfidat dhe Efektet e Zbatimit të Ligjit 75/2019 “Për Rininë” », ku pjesa më e madhe e pjesëmarrësve theksojnë se kanë pasur një besim të ulët në këtë proces e për pasojë kanë shmangur edhe aplikimin në thirrjen e parë për projekt ide. Shqetësime të tjera që ato kanë hasur apo evdientuar lidhur me thirrjen e parë për projekt propozime rinore kanë të bëjnë me procedurat e aplikimit, procesin e përzgjedhjes së fituesve, kompetencat aktuale të AKR dhe stafi implementues i funksioneve të saj si dhe periudhën e hapjes së thirrjes së për projekt propozime.

90% e organizatave vlerësojnë se ekzistenca e një Agjencie të dedikuar për rininë rrit vëmendjen dhe suportin ndaj të rinjve, por vetëm 29% e tyre kanë marrë pjesë në takime të organizuara prej AKR-së, duke u shprehur si në rastin e MSHRF se nuk kanë marrë ftesa për tu bërë pjesë e tyre. Interesant është fakti se pavarësisht se fondi për grante i AKR për vitin 2021 ishte në një vlerë të përafërt me atë të AMSHC, organizatat janë të pakënaqura me shifrën. 76 % e tyre shprehen se ky fond është

## **Shqetësimet dhe problematikat e evidentuara prej tyre janë si mëposhtë:**

- Procedurë e komplikuar aplikimi: Sipas organizatave të shoqërisë civile procedura e aplikimit gjatë thirrjes së parë për projekt propozime rinore ishte një procedurë e komplikuar dhe aspak suportuese sidomos për organizatat rinore dhe organizatat e reja. Sipas tyre dokumentacioni i kërkuar është voluminoz dhe kërkon persona të specializuar për shkrimin e projekt propozimit dhe dërgimin e paketës së aplikimit, gjë që sipas tyre penalizon strukturat rinore përball organizatave më me eksperiencë në këtë sektor.

- Mungesa e specifikimit të fushave të veprimit të thirrjes së parë për projekt propozime rinore: OSHC-të e përfshira gjatë fokus grupit të dedikuar shprehën se fusha e veprimit dhe prioritetet e thirrjes ishin shumë të gjera dhe jo të mirëspecifikuara, gjë që sipas tyre lë vend për interpretim dhe subjektivitet më të madh si nga ana e aplikantëve ashtu edhe nga ana e vlerësuesve të projekt ideve. Sipas tyre, ndërhyrjet e propozuara ose llojet e aktiviteteve që mbështeten nga thirrja duhen specifikuar dhe qartësuar për të gjithë aplikantët në vijim.

- Mungesa e një zëri të dedikuar për grupimet jo-formale dhe individët: Një tjetër shqetësim që ngrihet nga organizatat rinore është fakti se thirrja e parë për projekt propozime rinore është konceptuar si një mekanizëm mbështetës vetëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe organizatat rinore dhe për të rinjtë. Sipas OSHC-ve kjo është një pengesë kryesore sidomos për të rinjtë që jetojnë në zona rurale ose qytete të vogla, ku në pamundësi për formalizimin e strukturave rinore, grupet jo-formale janë më të përhapura se organizatat rinore ose për të rinjtë.

- Periudhë e papërshtatshme e hapjes së thirrjes së parë për projekt propozime rinore: Organizatat e shoqërisë civile shprehën se pavarësisht se thirrja për projekt propozime ka qëndruar e hapur për rreth 3 muaj, periudha e hapjes dhe mbylljes së thirrjes ka qenë e papërshtatshme për ta për të dërguar një projekt propozim cilësor në kohë pasi në këtë periudhë shume prej organizatave por edhe anëtarë të stafit që punojnë në administratën shtetërore nuk kanë qenë të pranishëm si pasoje e lejeve vjetore në stinën e verës. Kjo ka krijuar vështirësi në marrjen e dokumentacionit në kohë dhe depozitimin e tyre brenda afatit të mbylljes së thirrjes.

- Mungesa e transparencës për procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së ideve fituese: Transparenca dhe vlerësimi i projekt ideve në fakt është një ndër pikat që ka ngjallur më shumë diskutime dhe reagime nga anëtarët e pranishëm në takim. Sipas tyre procesi i përzgjedhjes së ideve fituese nuk ka pasur transparencën e duhur pasi kriteret e vlerësimit dhe anëtarët e komitetit përzgjedhës së projekt ideve nuk janë bërë publike. Gjithashtu, ka anëtarë të tjerë që shprehën se kanë aplikuar dhe nuk janë shpallur fitues në këtë thirrje. Megjithatë, ajo që i shqetëson këta aplikantë është fakti që në momentin që kanë depozituar një kërkesë për sqarime të mëtejshme lidhur me rezultatin e vlerësimit nuk kanë marrë përgjigje zyrtare ose kanë marrë një përgjigje jo mirë të artikuluar dhe specifikuar me arsyet e refuzimit të idesë së tyre.

- Përfshirja e njësive të vetëqeverisjes vendore në thirrjen e parë për projekt propozime: Një pikë tjetër diskutimi lidhur me aktorët e lejuar për dërgimin e projekt ideve gjatë thirrjes së parë të granteve nga AKR, u zhvillua pikërisht për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Sipas OSHC-ve, organet e pushtetit qendror duhet të gjejnë mekanizma të tjerë mbështetës ndaj institucioneve të vetëqeverisjes vendore dhe jo të përdorin thirrjen e hapur për projekt ide. Arsyetimi pas këtij qëndrimi lidhet me elementin e konkurrencës, gjithëpërfshirjes, mundësive të barabarta dhe njëanëshmërinë e procesit. Sipas përfaqësuesve të OSHC-ve, ky komponent rrit shancet për konkurrencën e pandershme, favorizimin e njësive të vetëqeverisjes vendore nga ana e AKR, limitimin e mundësive dhe fondeve për organizatat rinore dhe për të rinjtë si dhe nuk lë hapsirë për grupet e tjera sociale për të aplikuar dhe konkuruar me institucionet publike në këtë proces.

- Konfuzion lidhur me kompetencat dhe funksionet e AKR: Një tjetër evidentim dhe shqetësim i ngritur nga OSHC-të lidhur me punën e AKR ka të bëjë me kompetencat e AKR dhe rolin e saj në sektorin rinor. Sipas tyre, Ligji për Rininë ka të parashikuar ngritjen dhe formimin e disa strukturave dhe organeve të reja rinore të cilat duket se po krijojnë konfuzion dhe përsëritje të kompetencave/detyrave me njëra-tjetrën. Për këtë arsye ata propozojnë një rishikim të këtyre kompetencave dhe rolin dhe funksionin që ato duhet të kryejnë.

- Mungesa e nxitjes së bashkëpunimit midis aktorëve: Thirrja e parë për projekt ide duket se ka mbështetur vetëm aplikimet individuale të aktorëve të përfshire dhe nuk ka nxitur krijimin e konsortiumeve dhe bashkëpunimit midis aktorëve të lejuar për të aplikuar në thirrje. Sipas OSHC-ve kjo është një mungesë e cila duhet rikuperuar në thirrjet pasardhëse pasi jo vetëm do të ndihmonte në zhvillimin e kapaciteteve të organizatave rinore, por do të ndihmonte gjithashtu në forcimin e bashkëpunimit dhe dialogut ndër-institucional dhe midis aktorëve të përfshirë në proces, krijimin e mundësive për përfshirjen e organizatave që operojnë në zona rurale ose qytete të vogla dhe do të krijonte një ndjenjë të përbashkët përkatësie dhe përgjegjësie midis aktorëve të përfshirë. Megjithatë, sic u shpreh me herët, OSHC-të nuk përfshijnë bashkitë në këtë pikë.

- Kapacitete të limituara në implementimin e skemës së granteve nga stafi implementues i AKR: Duke qene një organ i ri i themeluar vetëm më 2 Shtator 2020, Agjencia Kombëtare e Rinisë, është një ndër përpjekjet e pakta qeveritare për të ardhur në ndihme organizatave rinore dhe për të rinjtë e cila operon me një buxhet të dedikuar për sektorin rinor. "Si rrjedhojë e periudhës së shkurtër prej së cilës operon, AKR ende nuk ka konsoliduar mënyrën e funksionimit e për pasojë as kapacitetet e stafit prej të cilit përbëhet", - shprehen organizatat pjesëmarrëse në fokus grupin e dedikuar për implementimin e Ligjit "Për Rininë". Organizatat të cilat kanë eksperiencë në sektorin rinor, pas njoftimit në rrjete sociale nga ana e AKR mbi ngritjen e kapaciteteve të stafit për menaxhimin e skemës së granteve dhe shkrimin e projekt propozimeve, shprehen se bashkëpunimi me Agjencinë e Kombeve të Bashkuara është një hap pozitiv sa i përket zhvillimeve të mëtejshme të kapaciteteve të brendshme dhe zhvillimit organizativ të AKR. Megjithatë, duke i njohur nga afër këto agjenci ata shprehin shqetësimin se procedurat e programeve/thirrjeve të Kombeve të Bashkuara shpesh herë janë të komplikuar dhe të vështira për tu përthithur nga organizatat rinore. Për këtë arsye OSHC-të sugjerojnë që të ketë reflektim të sugjerimeve të tyre në thjeshtësimin e procedurave të aplikimit.

- Mungesa e një Plani Veprimi nga AKR: Pika e fundit e diskutimit lidhur me rolin dhe funksionimin e AKR lidhet me ekzistencën e një plani veprimi nga ana e AKR ku të përfshihet qartë misioni/vizioni/objektivat dhe fushat e veprimtarisë së AKR duke e bërë kështu me të thjeshtë për të gjithë aktorët specifikimin e rolit/detyrave dhe përgjegjësive për të shmangur jo vetëm konfuzionin e opinionit publik, por edhe mospërsëritjen e roleve dhe detyrave midis institucioneve apo mekanizmave ekzistues.

## Perceptimi i OSHC-ve lidhur me Këshillin Kombëtar të Rinisë

Këshilli Kombëtar Rinor është gjithashtu një ndër mekanizmat që është themeluar si produkt i Ligjit për Rininë.

### Bazuar në Nenin 9 të këtij ligji, Këshilli Kombëtar i Rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme:

- a) i paraqet ministrit përgjegjës për rininë politikat prioritare, buxhetin dhe veprimtaritë në fushën e rinisë;
- b) propozon drejtimet dhe programet kryesore për mbështetjen dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së të rinjve;
- c) jep mendim për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe monitoron zbatimin e saj;
- ç) miraton raportin vjetor mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe situatës së të rinjve.



Figura 18: Perceptimi i OSHC-ve mbi KKR

mbi këtë çështje. Ata gjithashtu kanë evidentuar një sërë problematikash në funksionimin e kësaj strukture duke përfshirë mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve, rregulloren e brendshme, efektivitetin e anëtarëve aktual si dhe transparencën dhe vizibilitetin e punës që është bërë deri më tani.

Megjithatë që nga momenti i themelimit e deri më tani, OSHC-të shprehen se ky organ nuk ka pasur ndonjë funksion të dukshëm apo ndonjë kontribut madhor në politikat rinore. Vetëm 48% e organizatave mendojnë se ekzistenca e Këshillit Kombëtar të Rinisë ka sjellë ndryshime pozitive në sektorin e rinisë, 29% e tyre vlerësojnë se ky organ nuk ka sjellë ndryshime në sektor. Një pjesë e madhe e organizatave (24%) nuk kanë ndonjë opinion






Figura 20: Perceptimi i OSHC-ve mbi kapacitetet e KKR

Vetëm 18% e organizatave të pyetura mendojnë se KKR ka kapacitetet dhe burimet e duhura për të ofruar ekspertizën e duhur për të propozuar ndryshime në politika dhe buxhetin për rininë. 32% janë skeptikë ndërsa 50% nuk kanë informacion mbi këtë çështje. 62% e organizatave shprehen se pozicionimi i Minsitrit për Rininë dhe Fëmijët në krye të KKR limiton veprimtarinë dhe pavarësinë e anëtarëve të tij dhe vetëm 19% shprehen se ky

pozicionim i jep më shumë peshë rolit të këtij organi në nivel qendror. Një tjetër arsye sipas tyre lidhur me limitimin e pavarësisë së këtij organi ka të bëjë më mbingarkesën e punëve dhe faktin se stafi i MSHRF është i vogël në numër për të ndjekur të gjitha çështjet me efikasitetin dhe produktivitetin e duhur. Sipas tyre, edhe vetë anëtarët nuk ndihen të lirshëm për të folur hapur mbi problematikat dhe ti adresojnë ato tek aktorët e duhur.

### **Problematikat kryesore që OSHC-të kanë evidentuar janë:**


- Mënyrë jo adequate në përzgjedhjen e anëtarëve: OSHC-të shprehin shqetësimin e tyre lidhur me mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve. Sipas tyre përzgjedhja nëpërmjet një procesi votimi, rrit konkurrencën midis anëtarëve dhe nuk paraqet domosdoshmërisht përfaqësimin cilësorë nga ana e tyre. "Kjo mënyrë gjithashtu lë vend që anëtarët të caktohen bazuar në popullaritetin e tyre dhe fushatës elektorale që ata do të zhvillojnë dhe jo platëformës apo ideve që ato paraqesin si pjesë e kësaj strukture", - shprehen OSHC-të.
- Mungesa e autonomisë së funksionimit të strukturës duke përfshirë funksionimin dhe rregulloren e brendshme: Një tjetër shqetësim lidhur me KKR nga ana e organizatave rinore lidhet me autonominë dhe rregulloren e brendshme, ku në pikën 3, Neni 9 të Ligjit "Për Rininë" shprehet qartë se kriteret dhe procedurat e zgjedhjes së anëtarëve, si dhe mënyra e organizimit dhe e funksionimit të brendshëm të KKR bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave. OSHC-të shprehin se kjo pikë limiton përmbushjen e rolit dhe funksionit që secili nga anëtarët e KKR ka dhe rrit shancet për përdorimin e kësajë strukture në mënyrë fiktive për legjitimimin e vendimeve politike nga organet vendimarrëse.
- Mungesa e transparencës dhe vizibilitetit: Edhe pse deri më tani, KKR ka zhvilluar vetëm 3 takime zyrtare, përfaqësues të OSHC-ve shprehen se nuk ka pasur një informim të duhur të publikut dhe aktorëve të tjerë lidhur mbi çështjet që janë diskutuar apo vendimet që janë marrë gjatë këtyre takimeve. Ata shprehin se mungesa e transparencës, përpos problematikave të tjera, gjithashtu rrit shancet për të ulur besimin e të rinjve në sektorin rinor dhe zbeh angazhimin e tyre aktiv në proceset vendimarrëse.

- Mungesa e qasjes nga poshtë-lart: Bazuar në të drejtën e informimit dhe parimin e gjithëpërfshirjes, OSHC-të shprehen se KKR duhet të kishte pasur një rol me aktiv në ndërlikohen e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe aktorëve lokalë. Ata shprehen se KKR duhet të bazohet në qasjen nga poshtë-lart kur vjen puna tek konsultimi me grupet e interesit apo aktorë të tjerë social lidhur me çështjet apo politikat për të cilat KKR jep kontribut. Ata theksojnë se për çështje të një rëndësie kombëtar si Strategjia Kombëtare e Rinisë apo buxhetimi vjetor për rininë, KKR nuk duhet të paraqes një qëndrim pa u konsultuar më parë me një sërë aktorësh në 12 qarqet e Shqipërisë.

## Perceptimi i OSHC-ve lidhur me Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore

**Ligji 75/2019 “Për Rininë” parashikon themelimin e Organizatës Kombëtare Përfaqësuese Rinore. Specifikisht në nenin 13 në saj specifikohet se:**

1. Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore është një organizatë që themelohet, organizohet dhe funksionon në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse dhe e ushtron veprimtarinë në përputhje me statutin e saj.
2. Të drejtën për të themeluar Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore e kanë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, të cilat pranojnë qëllimin, fushën e veprimtarisë dhe përcaktimet e tjera të kësaj organizate, të rregulluara në statutin e saj.
3. Kriteret që duhet të përmbushë Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore, për t'u njohur si e tillë nga institucioni përgjegjës për rininë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



**Figura 21:** Perceptimi i OSHC-ve mbi qartësinë e dispozitave ligjore lidhur me OKP

Përveç këtij përkufizimi, i vetmi zhvillim që lidhet me OKP është VKM e datës 12 Maj 2021 ku përcaktohen kriteret e aplikimit për themelimin e kësaj organizate. Ajo që ende mungon janë zhvillimet e mëtejshme lidhur me rolin, kompetencat apo modalitetet e funksionimit të kësaj strukture. Për këtë arsye në thirrjen e hapur që në datën 31 Maj 2021 nuk ka pasur asnjë aplikim nga përfaqësuesit e shoqërisë civile. Si rrjedhim, qasja e

OSHC-ve është reflektuar edhe në stepjen e tyre për të aplikuar në këtë thirrje. Ata theksojnë se mungesa e qartësimin të këtij neni dhe akteve nënligjore të tij, përbën një risk shumë të madh për organizatat e shoqërisë civile pasi sipas tyre, OKP mund të humbasë autonominë dhe pavarësinë e veprimit dhe mund të përdoret për arsye politike. Deri më tani ata e cilësojnë themelimin e një organizate të re kombëtare përfaqësuese si një proces jo të nevojshëm dhe jo efektiv në kohë dhe kosto. 67% e organizatave të pyetura shprehen se ekzistenca e një organizate përfaqësuese për rininë do të sillte ndryshime pozitive në sektorin e rinisë, por vetëm 43% e tyre vlerësojnë se kompetencat dhe dispozitat në ligj janë të paqarta dhe të pamjaftueshme për të mundësuar mirëfunksionimin e saj.

## C. PERCEPTIMI I ORGANIZATAVE RINORE PËR IMPLEMENTIMIN E LIGJIT TË RINISË NË NIVEL LOKAL

Neni 10 i Ligjit 75/2019 "Për Rininë" parashikon edhe ngritjen e disa mekanizmave rinor në nivel lokal sic janë Këshillat Vendor Rinor. Bazuar në raportin "**Sfidat dhe Efektet e Zbatimit të Ligjit 75/2019 'Për Rininë'**", deri në periudhën Mars-Maj 2021 rreth 46% e bashkive që kanë marrë pjesë në studim, shprehen se nuk kanë avancuar me ngritjen e KVR dhe funksionimin e tyre. Kjo gjë në fakt është ndërë dhe nga OSHC-të të cilat shprehen se në ndryshim nga niveli qëndror, implementimi i Ligjit "Për Rininë" në nivel lokal ka pasur një ecuri më të ngadaltë.



Figura 22: Perceptimi i OSHC-ve mbi procesin e themelimit të KVR

57 % e organizatave shprehen se ngritja e Këshillave Vendore Rinorë e përmirëson rolin dhe pozitën e organizatave në nivel vendor, por gati gjysma e tyre (48%) vlerësojnë se procesi i ngritjes së tyre ka qënë jo transparent dhe jo në përputhje me ligjin për rininë. Kjo klimë mosbesimi duhet të korrektohet në 3 vjecarin e dytë të implementimit të ligjit me ndërhyrje për të siguruar depolitizim të KVR-vë dhe respektim

të garës vendore. Vetëm 24% e organizatave mendojnë se bashkitë i kanë kapacitetet e duhura për të përfunduar mirë funksionimin e Këshillave Vendorë Rinorë dhe anëtarët e KVR-ve kanë njohuritë e duhura për të përfaqësuar problematikat e rinisë, ndërkohë 62% e tyre janë skeptikë për sa i përket burimeve dhe kapaciteteve të bashkive ku operojnë dhe 53% mendojnë se anëtarët e KVR-ve nuk kanë kapacitete e duhura për të lobuar për problematikat dhe çështjet e rinisë. Pjesa tjetër e organizatave nuk kanë një opinion mbi këtë çështje.

Një pjesë e madhe e organizatave (67%) janë të njëjtit mendim se pozicionimi i Kryetarit të Bashkisë në krye edhe të KVR e limiton autonominë dhe funksionimin e Këshillave Vendorë Rinor. Ndërkohë nga ana tjetër 24% e tyre shprehen se ky pozicionim e përforcon rolin e Këshillit Vendor Rinor.




Figura 23: Perceptimi i OSHC-ve mbi kapacitetet e Bashkive për mbështetjen e KVR


62% e organizatave shprehen se bashkia e tyre nuk po bën mjaftueshëm për rininë, ndërkohë 68% mendojnë se bashkia nuk i ka burimet e mjaftueshme për të mundësuar mirë funksionimin e Këshillave Vendorë Rinorë, ndërsa 23% mendojnë që bashkia i ka këto resurse.

Më shumë se gjysma e organizatave janë shprehur se bashkia ku ato operojnë ka një strategji vendore për rininë (62%) dhe një specialist të dedikuar për çështjet rinore (53%), por vetëm 48% e tyre kanë kontaktuar të paktën një herë me personin përgjegjës për rininë.

72% e të pyeturve janë shprehur se zbatimi i ligjit në nivel vendor ka hasur problematika që sipas tyre lidhen me mungesën e një axhende pune nga ana e KVR-ve, mungesën e buxhetit të dedikuar për rininë, por edhe mungesën e njohurive të bashkisë mbi ligjin për rininë. 48% e organizatave mendojnë se mund të kontribuojnë vetë ato në hartimin e politikave vendore rinore, 33% mendojnë se organizatat mund të kontribuojnë më mirë në fuqizimin e rinjve në ushtrimin e demokracisë rinore dhe 19% shprehen se ato mund të ndihmojnë në rritjen e kapaciteteve të personave përgjegjës për rininë në bashki.

### **Problemet kryesore që ata evidentojnë janë:**

- Mungesa e informimit të të rinjve: Ato theksojnë se ka një mungesë informimi të theksuar nga ana e të rinjve lidhur me ekzistencën e ligjit dhe zhvillimeve që ai parashikon për të rinjtë.
- Mungesa e programeve dhe buxhetit të dedikuar për rininë: Gjithashtu OSCH-të shprehen se sërish në pjesën më të madhe të bashkive ku ata operojnë, nuk ka pasur një program dhe buxhet të dedikuar për rininë gjatë vitit 2022, çka ka sjellë që implementimi i këtij ligji në shumë bashki të mbetet vetëm në letër.
- Mungesa e personit përgjegjës për rininë: Shqetësim madhor nga ana e OSHC-ve është gjithashtu mungesa e personave të specializuar në çështjet rinore nga ana e stafit të institucioneve në nivel lokal. Ata shprehen se në shumë nga bashkite mungojnë specialistët e deikuar për rininë dhe se kompetencat e rinisë u janë veshur specialistëve ekzistues të cilat janë të pa kualifikuar dhe të pa trajnuar për mirëfunksionimin e këtij funksioni.



## KAPITULLI 4: PERCEPTIMI I TË RINJVE MBI IMPLEMENTIMIN E LIGJIT 75/2019 “PËR RININË”

Në mënyrë që ky raport të jetë i plotë dhe të përfshijë perceptimin e sa më shumë aktorëve që lidhen me politikat dhe sektorin rinor, kemi integruar edhe perceptimin e vetë të rinjve mbi implementimin e Ligjit të Rinisë 75/2019.

Mbledhja e të dhënave që janë paraqitur në këtë kapitull, është bërë nëpërmjet një pyetësoi online dhe përfshinë 180 të rinj të moshës 15-29 vjeç të cilët jetojnë në 12 qarqet e Shqipërisë. Nga ky kampion, 55% e të rinjve janë në arsimin e mesëm të lartë (gjimnaz); 35% janë në arsimin universitar, 7% në arsimin profesional dhe 3% e tyre janë të punësuar. Gjithashtu, nga përgjegjet e të rinjve evidentohet se 53% e tyre janë në angazhuar në organizata të shoqërisë civile ndërkohë që 47% e tyre nuk janë të angazhuar.

### A. NIVELI I INFORMIMIT MBI LIGJIN 75/2019 “PËR RININË”

Elementi i parë që është synuar për të qenë pjesë e kësaj analize, është niveli i informimit të të rinjve mbi Ligjin e Rinisë, ndryshimeve që ai sjell apo ngritjen e institucioneve të reja që ai parashikon.

Kështu, **64% e të rinjve shprehen se janë në dijeni që ekziston një Ligj për Rininë, në ndryshim nga 36% e tyre që nuk kanë asnjë dijeni mbi këtë ligj.** Burimet kryesore që ata listojnë në marrjen e këtij informacioni janë kanalet e medias vizive ose të shkruar (22%); rrjetet sociale të institucioneve (17%); institucionet arsimore (13%); faqet zyrtare të organizatave rinore (12%); rrjetet sociale të organizatave rinore (11%); nga të afërm në rrjetin e tyre familjar/shoqëror (11%) dhe faqet zyrtare të institucioneve (10%). Pjesa tjetër rendit burime të tjera të cilat nuk janë specifikuar.

Pavarësisht se pjesa me e madhe e të rinjve kanë shprehur se kanë dijeni për ekzistencën e ligjit, 60% e tyre shprehën se nuk janë në dijeni të ndryshimeve që ky ligj parashikon. Situatë e ngjashme paraqitet edhe për **Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencinë Kombëtare të Rinisë**, ku respektivisht 80% dhe 60% e të rinjve të anketuar kanë shprehur se kanë degjuar mbi ekzistencën e tyre. Por ajo që vihet re, është niveli ulët i informimit mbi kompetencat që ligji i rinisë parashikon për keto 2 struktura, pasi 55% e të rinjve shprehën se nuk janë në dijeni për kompetencat e MSHRF dhe 63% e tyre mbi kompetencat e AKR. Nga të dhënat rezulton se niveli i informimit mbi MSHRF është më i lartë në krahasim me AKR. Ndër shkaqet kryesore të këtij ndryshimi mund të jetë fakti se puna e AKR është më e lidhur me organizatat rinore dhe bashkitë.

Një situatë e ngjashme paraqitet edhe për Këshillin Kombëtar të Rinisë ku 70% e të anketuarve shprehën se kanë degjuar më parë për këtë organ, por 62% e tyre nuk kanë asnjë dijeni për kompetencat dhe rolin që ai duhet të kryej. Në ndryshim me KKR, 63% e të rinjve shprehën se kanë degjuar më parë për ekzistencën e Këshillave Vendor Rinor, por sërisht niveli i informimit mbi kompetencat e tyre mbetet i ulët pasi 62% e tyre nuk kanë dijeni mbi rolin dhe funksionin e tyre.

Në të njëjtën linjë të rinjtë shprehën edhe për **Organizatën Kombëtare Përfaqësuese** ku 52% e të rinjve thone se nuk kanë degjuar më parë për këtë strukturë dhe 62% e tyre nuk kanë informacion mbi rolin dhe kompetencat e saj. Lidhur me Regjistrin Elektronik për të Rinjtë, 56% e tyre nuk kanë dijeni që ligji 75/2019 parashikon ekzistencën e tij dhe 65% e tyre nuk janë familjar me përmbajtjen apo rolin që ky regjistër supozohet të ketë.

## B. PERCEPTIMI I TË RINJVE PËR IMPLEMENTIMIN E LIGJIT TË RINISË NË NIVEL QËNDROR

### Perceptimi i të rinjve mbi Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët (MSHRF)

Njëjtë me bashkitë dhe organizatat e shoqërisë civile, pjesa me e madhe e të rinjve (92%) shprehën se ekzistenca e një Ministri të dedikuar për Rininë dhe Fëmijët rrit vëmëndjen kundrejt të rinjve në nivel institucional.

#### **Ndër arsyt kryesore ata rendisin:**

- Ekzistencën e një organi koordinues dhe mbikqyrës në fushën e rinisë
- Diferencimin e portofolit rinor për herë të parë nga fushat e tjera
- Rritjen e vëmëndjes ndaj çështjeve të rinisë në nivel institucional dhe qeveritar
- Përkushtimin e një instance shtetërore vetëm në çështjet e rinisë
- Legjitimitetin e MSHRF për të lobuar/advokuar në ministritë e linjës mbi problematikat e të rinjve
- Mundëson komunikimin dhe përfshirjen e drejtëpërdrejtë të të rinjve në proceset vendimarrëse (psh. Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029)

Megjithatë pjesa e mbetur e të rinjve (8%) të cilët janë përgjigjur negativisht, shprehen se MSHRF duke mos pasur një portofol dhe buxhet të dedikuar, mund të kete veprimtari të limituar në përbushjen e funksionit të parashikuar në ligj e për rrjedhim impakt të limituar në lidhje me politikat rinore.



Figura 24: Perceptimi i të rinjve mbi zhvillimet rinore 2019-2022

Pavarësisht se pjesa më e madhe e të rinjve e mbeshtesin idenë e të pasurit një ministër shteti të dedikuar për rininë dhe fëmijët, pjesa dërrmuese e tyre (80%) shprehen se nuk kanë marrë ndonjë herë pjesë në aktivitete/takime apo programe që organizohen nga MSHRF. Ndër arsyt kryesore ata rendisin mungesën e informimit mbi të tilla takime/organizime; përplasjen e zhvillimit të këtyre takimeve me shkollën apo impenjimet personale si dhe

limitimin e pjesëmarrjes si pasoje e mungesës së transportit apo infrastrukturës së nevojshme për të aksesuar të tilla evente.

Njëjtë me organizatat rinore dhe bashkitë, pjesa më e madhe e të rinjve (45%) shprehen se ka pasur një përmirësim në sektorin rinor në 3 vitet e fundit, por gjithashtu një pjesë e mirë e tyre (20%) thonë se situata nuk ka ndryshuar. 25% e të rinjve shprehen se nuk janë në dijeni ose nuk kane informacion mbi këtë situatë.

Një nga gjetjet më interesante në këtë seksion lidhet me vlerësimin që vetë të rinjtë i kanë bërë MSHRF në përbushje të Nenit 5 mbi Ministrinë Përgjegjëse për Rininë.

Sic mund të shihet edhe në paraqitjen grafike të figures 25, ndryshe nga bashkitë të cilat kishin një vlerësim të lartë mbi këtë organ, të rinjtë duket se janë shprehur me nota mesatare ose të ulta ku duket qartësisht se prevalon vlerësimi në shkallën 2 dhe 3. (Bazuar në shkallën e vlerësimit nga 1 tek 5 ku 1=aspak dhe 5= plotësisht)

8. Në përbushje të nenit 7 mbi Ministrinë Përgjegjëse për Rininë vlerësoni nga 1 tek 5 (1=aspak, 5= plotësisht) sa i ka përbushur Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijë...etyrimet ligjore që parashikon Ligji 75/2019 "Për Rininë"




Figura 25: Vlerësimi i të Rinjve mbi rolin/funksionin e Ministrisë së shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Në ndryshim nga niveli i lartë i informimit mbi ekzistencën e MSHRF, 70% e të rinjtë shprehen se nuk kanë dëgjuar më herët mbi Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029. Megjithatë, 65% e tyre gjykojnë se ekzistenca e një dokumenti strategjik për rininë do ti shërbeje atyre për të adresuar më mirë problematikat rinore dhe për të gjetur zgjidhje konkrete. Nderkohë e larte mbetet edhe përqindja e të rinjve të cilat kanë shprehur se nuk mund të japin një gjykim mbi këtë çështje duke qene se nuk kane informacionin e duhur (30%). I lartë është edhe numri i të rinjve të anketuar të cilët janë shprehur se nuk kanë marrë pjesë në takimet konsultuese mbi këtë strategji, kur rreth 80% e tyre deklarojnë se nuk kane pasur ftesë/informacion mbi zhvillimin e këtyre takimeve. Pjesa tjetër e të rinjve (16%) shprehen se kanë qenë pjesë e takimit që është realizuar në Korçë në Mars 2022.

## **Perceptimi i të rinjve mbi Agjencinë Kombëtare të Rinisë (AKR)**

Në ngjashmëri me ekzistencën për MSHRF, pjesa me e madhe e të rinjve të anketuar (76%) shprehin se ekzistenca e një agjencie të dedikuar për rininë rrit vëmëndjen dhe suportin ndaj të rinjve dhe organizatave që punojnë në sektorin rinor, ndërkohë që 20% e tyre deklarojnë se nuk kanë opinion mbi çështjen. Por nga ana tjetër, 81% e tyre deklarojnë se nuk kanë marrë pjesë në asnjë aktivitet/takim/program që implementohet nga AKR. Ndër arsyt kryesore ata sërish listojnë mungesën e informacionit mbi këto takime, faktin që nuk janë përzgjedhur në aplikimet që kanë bërë dhe përplasjen e periudhës së zhvillimit të aktiviteteve me shkollën apo obligime të tjera personale.

Lidhur me buxhetin që AKR ka në dispozicion për sektorin rinor, 54% e të anketuarve shprehen se nuk kane dijeni nëse ky buxhet mjafton apo jo ndërkohë që 26% e tyre thonë se ky buxhet është i pamjaftueshëm.

Në vlerësimin që të rinjtë i kanë bërë Vendimit Nr. 681, Datë 2.9.2020 Mënyrën e Krijimit, të Organizimit e të Funksonimit Të Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR), duket se ka një ngjashmëri me vlerësimin e tyre mbi MSHRF, pasi vlerësimet më të shpeshta mbi përmbushjen e detyrimeve ligjore që Ligji i Rinisë parashikon për AKR duket të jene në nivele të ulta-mesatare. Sic paraqitet ne figuren 26, vlerësimet kryesore që ato kanë shprehur për AKR janë në vlerën 2-3. (Bazuar në shkallen e vlerësimit nga 1 tek 5 ku 1=aspak dhe 5= plotësisht)



19. Në përmbushje VENDIMIT NR. 681, DATË 2.9.2020 MËNYRËN E KRIJIMIT, TË ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË RINI...jore që parashikon Ligji 75/2019 “Për Rininë”




Figura 26: Vlerësimi i të rinjve mbi rolin/funksionin e Agjencisë Kombëtare të Rinisë

## Perceptimi i të rinjve mbi Këshillin Kombëtar të Rinisë

Në ndryshim nga 2 strukturat e mëparshme, lidhur me Këshillin Kobëtar të Rinisë duket se pjesa me e madhe e të rinjve (58% e tyre) nuk kanë asnjë informacion lidhur me ekzistencën e Këshillit Kombëtar të Rinisë.

E njejta situatë duket se paraqitet lidhur me kapacitetet që kjo strukturë disponon në mënyrë që të përmbushë në mënyrën e duhur rolin dhe funksionin e tij, pasi 54% e të rinjve duket se nuk kanë informacion nëse ky organ ka kapacitetet dhe burimet e duhura për të ofruar ekspertizë në politikat rinore dhe për të propozuar programe/veprimtari dhe buxhetin për rininë. Ndërkohe vetëm 30% e të rinjve janë shprehur pozitivisht dhe rreth 15% e tyre thonë se ky këshill nuk i disponon këto kapacitete.

Megjithatë, duket se ka një ndryshim në perceptimin e të rinjve lidhur me kryetarin e Këshillit Kombëtar të Rinisë, pasi 44% e të rinjve deklarojnë se fakti që ky i fundit është njëherësh Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, luan një rol pozitiv në rolin e këtij këshilli dhe i jep më shumë peshë vendimeve të tij. Pavarësisht kësaj, një numër i konsiderueshëm i të rinjve (22%) shprehin se ky fakt limiton pavarësinë e këtij këshilli dhe veprimtartinë e tyre.

Në përmbushje të nenit 9 mbi Këshillin Kombëtar të Rinisë, të rinjtë kanë vlerësuar në një shkallë nga 1 tek 5 (1=aspak, 5= plotësisht) ecurinë e deritanishme të tij. Sic vihet re ne tabelen më poshtë, vlerësimi i tyre duket se është i ngjashëm me atë të MSHRF dhe AKR, ku pjesa me e madhe e të rinjve kanë shprehur vlerësim të ulët-mesatar të përkthyer në notën 2-3.

21. Në përmbushje të nenit 9 mbi Këshillin Kombëtar të Rinisë vlerësoni nga 1 tek 5 (1=aspak, 5=plotësisht) sa i ka përmbushur Këshilli Kombëtar i ...et ligjore që parashikon Ligji 75/2019 "Për Rininë"




Figura 27: Vlerësimi i të rinjve mbi rolin/funksionin e Këshillit Kombëtar të Rinisë

## Perceptimi i të rinjve mbi Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore (OKPR)

Në lidhje me Organizatën Përfaqësuese Kombëtare Rinore, 70% e të rinjve duket se kanë një gjykim pozitiv dhe shprehen se ekzistenca e këtij organi do të sillte përmirësime në sektorin rinor. Megjithatë sërish pjesa me e madhe e tyre thone se nuk kanë dijeni për rolin/funksionin konkret që kjo strukturë duhet të luaj ku rreth 60% e tyre nuk janë në dijeni të dispozitave aktuale ligjore që Ligji i Rinisë përfshin për këtë strukturë.

## C. PERCEPTIMI I TË RINJVE PËR IMPLEMENTIMIN E LIGJIT TË RINISË NË NIVEL LOKAL

### Perceptimi i të rinjve mbi Këshillat Vendor Rinor

Duke qene se ky raport synon të japë një pasqyrë sa më të plotë mbi perceptimin e të rinjve lidhur me implementimin e Ligjit të Rinisë, një seksion i dedikuar i është kushtuar edhe perceptimin që ato kanë për ecurinë e këtij ligji në nivel lokal. Kështu, 67% e tyre e gjykojnë pozitive ekzistencën e Këshillave Vendorë Rinor, megjithatë rreth 50% e tyre nuk janë në gjendje të specifikojnë rolin/funksionin e këtyre këshillave si dhe nuk mund të gjykojnë mbi procesin e ngritjes se tyre për shkak se shprehen se nuk kanë informacionin e duhur mbi këtë çështje.

Në ndryshim nga perceptimi i organizatave rinore dhe bashkive, rreth 40% e të rinjtë mendojnë se bashkia në të cilën ata jetojnë, ka kapacitetet dhe burimet e duhura për të siguruar mirefunksionimin e këshillave vendor rinor dhe për të zgjidhur problematikat që ata adresojnë. Por në të njëjtin nivel (40%) janë edhe të rinjtë që deklarojnë se nuk kanë asnjë informacion për këtë çështje.

Situatë e ngjashme paraqitet mbi kapacitetet e anëtarëve të KVR ku 46% e të rinjve mendojnë se anëtarët e Këshillit Vendor Rinor në bashkinë e tyre kanë njohuritë dhe kapacitetet e duhura për të adresuar sic duhet problematikat e të rinjve dhe për të lobuar për zgjidhjen e tyre pranë institucioneve lokale. Me një ndryshim të lehtë, në numër të konsiderueshëm janë edhe të rinjtë që deklarojnë se nuk kanë asnjë informacion mbi këtë pikë (40%).

Mbi kryetarin e këshillave vendor rinor, të rinjtë duket se janë në të njëjtën linjë gjykimi me kryetarin e këshillit kombëtar të rinisë, ku duhet se pjesa më e madhe e tyre 40% thonë se fakti që kryetari i bashkisë është njëherësh kryetari i KVR është pozitive dhe mund të sjellë ndryshime më të shpejta të realiteteve ku ato jetojnë. Megjithatë, sërisht një numër i lartë të rinjsh (37%) shprehen se nuk kanë asnjë informacion mbi çështjen dhe nuk mund të japin një opinion.

## Perceptimi i të rinjve mbi Bashkitë

Elementi tjetër që është përfshirë nga ekspertët në pyetësorët e hartuar për të rinjtë janë bashkitë në mënyrë që të reflektohet perceptimi i të rinjve mbi punën që institucionet lokale kryejnë lidhur me sektorin rinor.

Ajo që të rinjtë deklarojnë mbi këtë aspekt, është se pjesa më e madhe e bashkive nuk arrijnë të përmbushin nevojat e të rinjve në nivel lokal. 43% e tyre shprehen se bashkia e tyre nuk po bën mjaftueshëm për rininë, ndërkohë që 30% e tyre nuk kanë informacion mbi këtë aspekt. Nga përgjigjet e deklaruara prej tyre, edhe pse duket se ka një ndërgjegjësim më të madh të bashkive 2 vitet e fundit, sërisht ka shumë punë për të bërë në nivel lokal, duke përfshirë edhe zonat rurale të cilat sado që janë pjesë e çdo politike apo diskursi publik, mbeten sërisht më të disadventazuara nga zonat e tjera. Për më tepër, 46% e tyre mendojnë se bashkitë nuk kanë mjaftueshëm kapacitete njerëzore dhe resurse financiare që mundësojnë mirëfunksionimin e Këshillave Vendor Rinor dhe përmirësimin e problematikave të të rinjve në nivel lokal, 30% e tyre nuk kanë informacion mbi çështjen ndërkohë që vetëm 14% e pohon këtë fakt.

## Perceptimi i të rinjve mbi aspekte të tjera që lidhen me rininë në nivel lokal

Për të pasur mundësi të gjenerojmë të dhëna krahasuese mbi perceptimin që të rinjtë kanë lidhur me ekzistencën e një dokument strategjik për rininë në nivel lokal kemi integruar disa pyetje që synojnë të paraqesin nivelin e informimit dhe vlerësimit të tyre mbi këtë aspekt.

Nga të dhënat rezulton se 37% e të rinjve nuk kanë degjuar më parë mbi Strategjitë Lokale të Rinisë ndërkohë që 22% e tyre nuk kanë informacion mbi çështjen. Vetëm 41% e tyre deklarojnë se kanë dëgjuar më parë mbi këtë dokument, por 44% e tyre deklarojnë se nuk kanë informacion nëse bashkia e tyre ka një plan zhvillimi për rininë. Nndërkohë 20% e tyre shprehen se ky dokument nuk ekziston.


Lidhur me personin përgjegjës për rininë, 44% e të rinjve të anketuar shprehen se janë në dijeni që Ligji për Rininë parashikon përcaktimin e të paktën një personi përgjegjës për rininë në nivel lokal, por sërish pjesa më e madhe e tyre (47%) shprehen se nuk kanë pasur asnjë kontakt apo komunikim së paku një herë me personin përgjegjës për rininë në bashkinë ku ata jetojnë. Nga ana tjetër, 30% e të rinjve shprehen se nuk janë në dijeni të këtij informacioni.

Lidhur me nivelin e informimit të të rinjve mbi implementimin e ligjit të rinisë në nivel lokal, pjesa më e madhe e të rinjve (40%) mendojnë se procesi i informimit të të rinjve është bërë në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë grupimet e të rinjve. Nga ana tjetër i lartë është edhe numri i të rinjve që shprehen se nuk kanë informacion për këtë pjesë (37%). Gjithashtu 48% e tyre thonë se nuk kanë asnjë informacion mbi parimet që bashkitë janë përmbytur për implementimin e këtij ligji në nivel lokal.

Në këtë linjë, të rinjtë kanë evidentuar disa problematika lidhur me këtë proces. Të rinjtë deklarojnë nivelin e ulët të informimit mbi aplikimin për tu bërë anëtar të KVR (në ato bashki ku janë ngritur këto këshilla), ndryshimin e shpeshtë të anëtarëve pasi shumica e të rinjve largohen nga bashkitë e tyre në Tiranë ose jashtë vendit, faktin që ligji lë hapësirë për interpretim dhe nuk është shumë specifik mbi KVR dhe ecurinë e ngadaltë të proceseve që lidhen me ecurinë e ligjit në nivel lokal, ku nga mbingarkesa që personat përgjegjës në bashkitë e tyre kanë, mbledhjet apo aktivitetet që zhvillojnë janë të rralla (sidomos në bashkitë e vogla).

## D. PERCEPTIMI I TË RINJVE MBI ROLIN E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË IMPLEMENTIMIN E LIGJIT TË RINISË

Njësoj si bashkitë apo përfaqësuesit e institucioneve, edhe pjesa më e madhe e të rinjve (60%) mendojnë se organizatat e shoqërisë civile do të kishin sjellë një impakt pozitiv në implementimin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë". Gjithashtu, 65% e tyre mendojnë se bashkëpunimi midis organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të pushtetit lokal do të kishte sjellë një rezultat më të prekshëm në zgjidhjen e problematikave të të rinjve në nivel lokal. Për më tepër, 57% e të rinjve deklarojnë se niveli i besimit nga të rinjtë është më i lartë tek institucionet e pushtetit lokal apo organizatat e shoqërisë civile. Nga ana tjetër, 65% e të rinjve mendojnë se organizatat e shoqërisë civile duhet të luajnë një rol më aktiv në informimin e të rinjve dhe fuqizimin e tyre lidhur me ndryshimet që parashikon të sjellë Ligji 75/2019 "Për Rininë".



## KAPITULLI 5: IMPLEMENTIMI I LIGJIT PËR RININË DHE E ARDHMJJA, SFIDAT DHE MUNDËSITË

Ligji i Rinisë 75/2019 është miratuar në vitin 2019, por deri në vitin 2021 implementimi i tij duket se ka ecur me hapa të ngadaltë. Ajo që vihet re nga raporti monitorues "Sfidat dhe Efektet e Zbatimit të Ligjit 75/2019" duket se ka pasur një hendek midis zhvillimeve në nivel qendror dhe atë lokal, gjë që përforcohet edhe nëpërmjet përditësimit të të dhënave të cilat janë integruar në këtë raport.

Përsa i përket kuadrit ligjor dhe institucional, duket se Ligji "75/2019" ka sjellë një fokus të shtuar tek rinia dhe sektori rinor, gjë që është evidentuar nga një sërë aktorësh të shoqërisë civile, përfaqësues të pushtetit lokal si dhe vetë të rinjtë e përfshirë në këtë raport.

Nga analiza e të dhënave të paraqitura në kapitujt pararendës, duket se perceptimet e të rinjve, organizatave rinore/për të rinjtë dhe përfaqësuesve të bashkive kanë pikëprerje dhe ngjashmëri në disa aspekte. Të gjithë aktorët shprehen se ekzistenca e një ministri të dedikuar për rininë dhe fëmijët është një zhvillim pozitiv dhe nxjerr më në pah rëndësinë e përfshirjes së të rinjve në proceset vendimarrëse dhe politikat sektoriale. E njëjta situatë paraqitet edhe në lidhje me rolin që OSHC-të mund të luajnë gjatë procesit të implementimit të Ligjit për Rininë ku të gjithë aktorët e mbështesin përfshirjen e organizatave rinore/për të rinjtë dhe ofrimin e ekspertizës/eksperiencës së tyre në këtë proces.

Perceptimet e të rinjve, organizatave rinore/për të rinjtë dhe përfaqësuesve të bashkive paraqesin ngjashmëri edhe në lidhje me kapacitetet/burimet e bashkive dhe anëtarëve të Këshillit Kombëtar Rinor dhe anëtarëve të Këshillave Vendor Rinor. Ata shprehen se pamjaftueshmëria e qasjes strategjike, resurseve si humane ashtu edhe financiare dhe kapacitetet/ekspertiza e limituar e anëtarëve që përbejnë këto struktura duket qartazi se ka pasur ndikim në ecurinë e deritanishme të këtij ligji. Sipas tyre këto ngerçe duhen adresuar menjëherë nga aktorët përgjegjës, ku sipas tyre rolin kryesor e luan Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Megjithatë duket se aktorët e përfshirë në këtë studim kanë qasje të ndryshme në lidhje me pjesën më të madhe të aspekteve që parashikon Ligji 75/2019.

Kështu për shembull, në ndryshim nga MSHRF, duket se ka një diferencim midis opinionit të bashkive dhe të rinjve mbi ekzistencën dhe rolin e AKR kundrejtë opinionit të OSHC-ve. Dy të parët e gjykojnë pozitiv rolin e AKR deri në këtë fazë, ndërkohë që OSHC-të duket se kanë një qasje pak me kritike lidhur me rolin/kompetencat e saj dhe procesin e mbështetjes së sektorit nëpërmjet granteve. Sipas këtyre të fundit, duket se ka një dublifikim të kompetencave ndaj ata propozojnë një rishikim të funksionit dhe rolit që AKR duhet të kryejë në vijim.

Nga ana tjetër duket se bashkitë dhe organizatat e shoqërisë civile janë me të informuar dhe të përfshirë në procesin e monitorimit të Ligjit për Rininë pasi janë në kontakt të vazhdueshëm me institucionet qoftë në nivel lokal e qëndror. Kjo situatë duket se nuk paraqitet e njëjtë tek të rinjtë ku pjesa më e madhe e tyre ndonëse mund të kenë hasur terma si MSHRF, AKR, Ligji i Rinisë, KKR etj duket se kanë një nivel të ulët informimi mbi kompetencat e tyre dhe ndryshimet që ky ligj parashikohet të sjell në sektorin rinor.

Lidhur me ekzistencën dhe rolin e KKR duket se të rinjtë janë më të distancuar në krahasim me OSHC-të apo përfaqësuesit e pushtetit lokal pasi pjesa më e madhe e tyre shprehen se nuk janë në dijeni për themelimin e këtij organi apo rolin/funksionin që ai duhet të kryejë.

Një nivel më i lartë informimi është paraqitur në lidhje me Këshillat Vendor Rinor. Të gjithë aktorët shprehen në menyrë pozitive për themelimin e tyre, por organizatat e shoqërisë civile duket se janë më skeptike në krahasim me aktorët e tjerë sidomos kur bëhet fjalë për autonominë dhe kapacitetet që këto struktura kanë për të përcuar problematikat e të rinjve përballë institucioneve vendore.

## KONKLUZIONET KRYESORE TË ANALIZËS

- 3 vjet pas hyrjes në fuqi të ligjit për rininë, kuadri ligjor është plotësuar ndryshe ai institucional është ende në proces. Organizata Kombëtare Përfaqësuese nuk u konstitua për shkak të mungesës së aplikimeve dhe paqartësisë së kompetencave. Institucionet përgjegjëse duhet të rishikojnë kriteret dhe funksionet e kësaj organizate në shprehjen e radhës për interesim të organizatave rinore.
- Për vitin e dytë radhazi AKR hapi thirrjen për aplikime për organizatat dhe bashkitë. Përfaqësuesit e organizatave e perceptojnë procesin si burokratik dhe kanë një nivel të ulët besueshmërie tek përzgjedhja dhe filtrimi i fituesve.
- Me shtimin e grupeve jo-formale dhe vështirësitë që has një organizatë e re për t'u regjistruar formalisht, rekomandohet që AKR të nxjerrë skema grantimi për individët dhe grupet jo-formale. Agjencia Kombëtare e Rinisë gjithashtu duhet të bëjë transparencë të plotë në procesin e vlerësimeve të projekt – propozimeve duke aplikuar modelin e komisionit të jashtëm në këtë proces dhe duhet të eliminojë burokracitë.

- Zgjedhja e Këshillit Kombëtar të Rinisë është shoqëruar me rezerva nga ana e organizatave të shoqërisë civile duke i cilësuar si mënyrë jo demokratike dhe jo gjithëpërfshirëse duke anashkaluar edhe qasjen e përfaqësimit nga poshtë - lart. Përcaktimi me VKM i mënyrës së organizimit dhe funksionimit të KKR çënon autonominë e kësaj strukture. Modeli i një Këshilli Rinor me sekretari dhe vendimmarrje autonome do të riste transparencën, vizibilitetin dhe llogaridhënien e qeverisë ndaj këtij organi.
- Strategjia e Rinisë pritet të jetë dokumenti bazë për të rritur ndikimin e ligjit për rininë tek ky komunitet. Këshilli i Ministrave miratoi në muajin dhjetor 2022 Strategjinë e Rinisë, por buxheti i shtetit i miratuar nga Parlamenti i Shqipërisë parashikoi 7 herë më pak se parashikimi për zbatimin e kësaj strategjie.
- Regjistri Elektronik për Rininë është konceptuar si një regjistër i brendshëm në shërbim të AKR dhe jo në shërbim të publikut. VKM për zbatim të ligjit kufizon aksesin e publikut. Në këtë kuptim publiku, të rinjtë dhe organizatat nuk do të kenë informacion të detajuar mbi të dhënat e organizatave rinore dhe për të rinjtë dhe fushën e veprimtarisë së tyre. Gjithësesi, edhe pse kanë kaluar 6 muaj nga nxjerrja e VKM në faqen zyrtare të AKR nuk është publikuar asnjë e dhënë mbi RER
- Ajo që vëhet re nga analiza e të dhënave, këtë vit duket se ka një zvogëlim të këtij hendeku zhvillimesh, pasi pjesa më e madhe e bashkive deklaroi se janë ngritur Këshillat Vendor Rinor.
- Në nivel lokal, duket se ka një ndërgjegjësim të institucioneve dhe prioritizim të rinisë në lidhje me politikat publike, por reflektimi i këtij prioritizimi në iniciativa konkrete nga ana e tyre është i vakët pasi burimet janë të limituara.
- Bashkitë shprehen entuziaste lidhur me mbështetjen financiare që kanë marrë nga AKR dhe deklarojnë se prioritet për këta në këto thirrje është përmirësimi i infrastrukturës rinore në nivel lokal.
- Bashkitë theksojnë mungesën e ekspertizës dhe kapaciteteve njerëzore si një ndër barrierat kryesore që ka sjelle implementimin e ngadaltë të këtij ligji.
- Bashkitë gjithashtu shprehen se ka një nevojë urgjente për themelimin e një sistemi gjenerimi të dhënash për rininë në secilin bashki, në mënyrë që të matet saktë ecuria e implementimit të ligjit, por edhe të furnizojnë procesin e politikave rinore dhe hartimin e dokumentave strategjik.
- Niveli i informimit të të rinjve lidhur me ekzistencën dhe kryesisht rolin e MSHRFAKR/ KKR/ OKPR/ RER dhe ndryshimeve që sjell ligji i rinisë mbetet shumë i ulët.

- Në ndryshim nga bashkitë, të rinjtë dhe OSCH-te rinore kanë një vlerësim mesatar-të ulët lidhur me performancën e institucioneve qendrore dhe lokale në përputhje me implementimin e nenve respektive që parashikon Ligji 75/2019.
- Të gjithë aktorë e përfshirë këtë studim shprehin se bashkepunimi me organizatat rinore/për të rinjtë gjatë hartimit, implementimit dhe monitorimit do të kishte sjelle një rezultat me efektiv dhe të pershpejtuar.
- Numri i të rinjve që vijnë nga grupe të marginalizuara, të rinjtë me aftësitë ndryshe, të rinjtë LGBTQ+, të rinjtë e pakicave etnike apo fetare është krahasimisht i ulët në raport me të rinjtë e tjerë të cilët janë berë pjese edhe e KVR-ve.
- Numri i të rinjve që shprehen se nuk kane marrë pjesë në asnje nga aktivitetet që ka zhvilluar MSHRF apo AKR është i lartë.

## 5.1 SFIDAT

### A. SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA NGA PËRFAQËSUESIT E BASHKIVE

1. Numër stafit të kualifikuar në punën rinore dhe ofrimin e shërbimeve për të rinjtë në nivel lokal mbetet i limituar
2. Numrit të trajnimeve, programeve për rritjen e kapaciteteve të punonjësve aktual në hartimin dhe dizenjimin e politikave, programeve, aktiviteteve rinore është shumë i ulët
3. Mungon ekspertiza e brendshme/ e jashtme mbi hartimin e dokumentave strategjik në nivel lokal
4. Hapsira/ infrastrukturë rinore/artistike/kulturore e cunguar në nivel lokal
5. Mundësi të pakta për rrjetëzim dhe shkëmbim eksperiencash me bashkitë simotra në rajon dhe Europë
6. Burimeve financiare të pamjaftueshme dhe suport i limituar nga pushteti qëndror në atë lokal për sektorin rinor
7. Ekspertizë e brendshme/e jashtme e ulët për gjenerimin e metodologjisë lidhur me hartimin dhe krijimin e databazes rinore në nivel lokal
8. Mungesa e një modeli/plani/dokumenti strategjik në nivel lokal & kombëtar që udhëzon gjenerimin dhe mbledhjen e të dhënave në sektorin rinor duke përfshirë dhe organizatat lokale



9. Mungesë kapacitetesh njerëzore dhe financiare për krijimin dhe mirëmbajtjen e një databaze të subjekteve rinore në nivel lokal
10. Mungesë organizatash lokale që operojnë në sektorin rinor (në bashkitë e vogla)
11. Mungesa e diferencimit të të dhënave për rininë nga të dhënat e tjera që gjenerohen në nivel lokal
12. Mungesa e stafit përgjegjës për rininë me persona të kualifikuar në hartimin, gjenerimin dhe analizimin e këtyre të dhënave
13. Dialog dhe bashkëpunimi i ulët me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe INSTAT
14. Gjenerimi i të dhënave të unifikuara për aktorët të cilët operojnë në fushë e rinisë (OJF, Institucione lokale/qëndrore)
15. Mungesa e suportit logjistik jo vetëm në metodologjinë e krijimit dhe mbledhjes së të dhënave, por edhe aspektit teknik dhe digjital që do të mundësojë përditësimin e tyre dhe publikimin e tyre në faqet zyrtare të bashkive
16. Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me OJF rinore/për të rinjtë
17. Krijimi një dokument strategjik që do të fasilitojë bashkëpunimin dhe punën me OSHC-të
18. Konceptimi/Hartimi/Implementimi i një skeme grantesh nga bashkia që i vjen në ndihmë OSHC-ve dhe zhvillimit të iniciativave rinore në nivel lokal
19. Dialogu dhe bashkëpunim i limituar midis OSCH-ve dhe Bashkive për aplikime të ndryshme në projekt propozime
20. Dialog dhe bashkëpunimi i limituar me organizata kombëtare, rajonale dhe Europiane me qëllim rrjetëzimin, shkëmbimin e eksperiencave dhe krijimin e partneriteteve të reja në fushën e rinisë

## B. SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA NGA OSHC-TË

1. Procedurë e komplikuar aplikimi ne skemën e granteve nga AKR
2. Mungesa e specifikimit të fushave të veprimit të thirrjes së parë për projekt propozime rinore
3. Mungesa e një zëri të dedikuar për grupimet jo-formale dhe individët ne thirrjet për projekt propozime nga ana e AKR
4. Mungesa e transparencës për procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së ideve fituese ne skemën e dhënies së granteve nga AKR
5. Përfshirja e njësive të vetëqeverisjes vendore në thirrjen e parë për projekt propozime
6. Konfuzion lidhur me kompetencat dhe funksionet e AKR
7. Mungesa e nxitjes së bashkëpunimit midis aktorevë ne dy thirrjet e menaxhuara nga AKR.
8. Kapacitete të limituara në implementimin e skemës së granteve nga stafi implementues i AKR
9. Mungesa e një Plani Veprimi nga AKR ku të përfshihet qartë misioni/vizioni/objektivat dhe fushat e veprimtarisë si dhe specifikimin e rolit/detyrave dhe përgjegjësive te saj
10. Mënyrë jo adeguate në përzgjedhjen e anëtarëve të KKR
11. Mungesa e autonomisë së funksionimit të KKR duke përfshirë funksionimin dhe rregulloren e brendshme
12. Mungesa e transparencës dhe vizibilitetit së KKR mbi takimet e zhvilluara deri më tani
13. Mungesa e qasjes nga poshtë-lart
14. Mungesa e informimit të te rinjve lidhur me aktoret kryesor në sektorin e rinise në nivel lokal e kombëtar dhe kompetencat që ligji 75/2019 parashikon për to
15. Mungesa e programeve dhe buxhetit të dedikuar për rininë ne nivel lokal
16. Mungesa, kompetenca të limituara ose mbingarkesë e personit përgjegjës për rininë në nivel lokal

## C. SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA NGA TË RINJTE

1. Nivel i ulët informimi mbi rolin/kompetencat e institucioneve përgjegjëse për rininë në nivel kombëtar e lokal
2. Nivel i ulët informimi lidhur me Strategjinë e Rinisë 2022-2029
3. Nivel i ulët informimi mbi buxhetin apo kapacitetet e institucioneve për mirë implementimin e Ligjit "Për Rininë".
4. Transparencë dhe gjithëpërfshirje e ulët e të rinjve gjatë ngritjes së KVR-ve
5. Mungesa e bashkëpunimi sistematik dhe koordinim i ulët midis institucioneve dhe OSHC-ve për përfshirjen e të rinjve në aktivitete/takime që lidhen me problematikat e tyre kryesore

## 5.2 MUNDËSITË

### A. REKOMANDIME PËR RRRITJEN E PERFORMANCËS SË MSHRF NË PËRPUTHJE ME LIGJIN "75/2019"

#### MSHRF

1. Përmirësimi i fushatave informuese për zhvillimet e Ligjit të Rinisë dhe sektorit rinor
2. Advokimi/lobimi në nivel qeveritar për shtimin e buxhetit për rininë
3. Hartimi i një programi asistence teknik dhe mbështetjen e bashkive për përmbushjen e dispozitave të parashikuara në Ligjin e Rinisë
4. Koordinim më i mirë midis aktorëve që punojnë në sektorin rinor për përfshirjen e të rinjve që i përkasin grupeve të disavantazhuara
5. Monitorimi sistematik i ecurisë së implementimit të Ligjit për Rininë
6. Rritja e transparencës lidhur me impaktin e iniciativave/aktiviteteve që zhvillohen nga MSHRF

## **B. REKOMANDIME PËR RITJEN E PERFORMANCËS SË AKR NË PËRPUTHJE ME LIGJIN "75/2019"**

### **AKR**

1. Rishikimi i procedurave të aplikimit për organizatat rinore/për të rinjtë në skemen e granteve e cila menaxhohet nga AKR
2. Krijimi i hapsirave të reja për mbështetjen e grupeve jo-formale dhe individëve
3. Hartimi i një plani veprimi të AKR-së
4. Rritja e nivelit të transparencës lidhur me vlerësimin dhe përzgjedhjen e projekteve fituese në thirrjet për projekt propozime
5. Rritje e kapaciteteve të stafit të brendshëm në menazhimin e granteve
6. Përmirësimi i fushatave informuese për aktivitete/projekte për të rinjtë
7. Rritje e vizibilitetit lidhur me zhvillimet e Regjistrimit Elektronik për Rininë

## **C. REKOMANDIME PËR RITJEN E PERFORMANCËS SË KKR NË PËRPUTHJE ME LIGJIN "75/2019"**

### **KKR**

1. Rishikimi i përzgjedhjes së anëtarëve të strukturës
2. Rritja e nivelit të transparencës lidhur me takimet/diskutimet e zhvilluara
3. Përmirësimi i vizibilitetit të punës së KKR
4. Rritja e nivelit të autonomisë së KKR
5. Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit midis anëtarëve të KKR-së së brendshmi
6. Rritja e kapaciteteve të anëtarëve lidhur me politikat rinore dhe propozimeve që depozitohen pranë MSHRF
7. Përmirësimi i qasjes së anëtarëve të KKR kundrejtë të rinjve të tjerë dhe konsultimi i sugjerimeve/propozimeve nëpërmjet modelit nga poshtë-lartë

## **D. REKOMANDIME PËR RITJEN E PERFORMANCËS SË BASHKIVE NË PËRPUTHJE ME LIGJIN "75/2019"**

### **BASHKIVE**

1. Rishikimi i caktimit dhe ushtrimit të kompetencave të personit përgjegjës për rininë në nivel lokal
2. Rritja e buxhetit të dedikuar për rininë në nivel lokal
3. Zhvillimi i Strategjive Vendore për Rininë në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029
4. Rritja e Kapaciteteve të brendshme në hartimin/zhvillimin e iniciativave rinore në nivel lokal
5. Gjenerimi i të dhënave për rininë në nivel vendor dhe diferencimi i tyre nga të dhënat e tjera që gjenerohen në bashki
6. Rritja e nivelit të transparencës lidhur me zhvillimin e sektorit rinor në nivel lokal duke përfshirë edhe KVR-të
7. Koordinim më i mirë me OSHC-të për ndërmarrjen e iniciativave rinore

## **E. REKOMANDIME PËR OSCH-TË LIDHUR ME IMPLEMENTIMIN E LIGJIT "75/2019"**

### **OSHC-VE**

1. Koordinimi dhe krijimi i koalicioneve në nivel vendor mes organizatave
2. Suporti dhe monitorimi i Këshillave Vendore për Rininë dhe axhendën e bashkisë për të rinjtë
3. Rritje e efektivitetit të fushatave informuese për të rinjtë sidomos për ata që vijnë nga grupe të disadventazhuara
4. Targetimi i bashkive të vogla të cilat nuk kanë prezentë të OSHC-ve dhe kanë kapacitete të imituara në ofrimin e shërbimeve publike për të rinjtë
5. Monitorimi i vazhdueshëm dhe përfshirja në procese kombëtare/ndërkombëtare që prekin direkt ose indirekt zhvillimet e sektorit rinor në Shqipëri

6. Rritja e “presionit” ndaj institucioneve qendrore dhe lokale mbi përfshirjen e të rinjve

7. Hartimi i programeve që targetojnë rritjen e kapaciteteve të të rinjve në nivel lokal kryesisht lidhur me të drejtat e tyre demokratike dhe mekanizmave që lejojnë përfaqësimin dhe përfshirjen e tyre në procese vendimarrëse


## F. REKOMANDIME TË TJERA

### OSHC-VE

1. Zhvillimi i Konferencës Kombëtar për Maturimin e Ligjit për Rininë

2. Rritja e proaktivitetit dhe përfshirjes së të rinjve në procese vendimarrëse që prekin interesat e tyre

3. Rol i shtuar i akademikëve në monitorimin e Ligjit për Rininë dhe informimit të studenteve lidhur me zhvillimet e ligjit për periudhën 2019-2022



## KAPITULLI 5: ANEKSET

### Aneksi I: Kërkesa për Informacion drejtuar MSHR\_Qershor 2022

#### Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Në kuadër të Programit të Kërkimit, Monitorimit dhe Vlerësimit, Kongresi Rinor Kombëtar me mbështetjen e Fondacionit Gjerman Konrad Adenauer ka vijuar punën për monitorimin e implementimit të "Ligjit për Rininë" dhe akteve nën ligjore të tij duke përfshirë: strukturat në nivel vendor, strukturat në nivel qendror dhe Agjencinë Kombëtare të Rinisë. Bazuar në gjetjet e raportit monitorues "Sfidat dhe Efektet e Zbatimit të Ligjit 75/19 Për Rininë" të cilin Kongresi Rinor Kombëtar e ka publikuar në fund të vitit 2021, puna e këtij viti konsiston jo vetëm në përditësimin e të dhënave të përfshira në këtë raport, por dhe analizimin dhe monitorimin e zhvillimeve që kanë ndodhur në periudhën Tetor-Qershor 2022. Metodologjia e raportit të këtij viti bazohet tek rishikimi i literaturës, dergimin e kërkesave për informacion ndaj institucioneve, zhvillimin e anketave me të rinjtë dhe OSHC-të dhe zhvillimin e fokus grupeve me aktorët kyç përgjegjës për mirëimplementimin e këtij ligji.

#### **Për këtë arsye, kërkojmë të na vihen në dispozicion të dhënat e më poshme:**

1. Cili është roli dhe kompetencat aktuale të MSHRF në implementimin e Ligjit të Rinisë?
2. Cilat janë zhvillimet/iniciativat kryesore që MSHRF ka ndërmarrë që prej Shtatorit 2021?
3. Cilat janë zhvillimet kryesore lidhur me Ligjin "per Rinine" nga MSHRF? A ka ndonjë diskutim për aktet nënligjore që ende nuk janë miratuar?
4. Në çfarë faze është implementimi i Ligjit Për Rininë në nivel lokal?
6. A ka ndonjë zhvillim lidhur me krijimin e organizatës përfaqësuese rinore?
7. Në cilën fazë është krijimi i regjistrit kombëtar për OSHC-të?
8. A ka ndonjë përpjekje nga MSHRF për të pasur një dialog të strukturuar me organizatat rinore lidhur me implementimin e Ligjit të Rinisë?
9. Cilat janë zhvillimet e fundit të Këshillit Kombëtar të Rinisë? Cilat janë arritjet dhe sfidat kryesore që janë hasur që prej themelimit të tij?

# Aneksi II: Kërkesa për Informacion drejtuar MSHR\_Tetor 2022

## Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Në kuadër të Programit të Kërkimit, Monitorimit dhe Vlerësimit, Kongresi Rinor Kombëtar me mbështetjen e Fondacionit Gjerman Konrad Adenauer ka vijuar punën për monitorimin e implementimit të "Ligjit për Rininë" dhe akteve nën ligjore të tij duke përfshirë: strukturat në nivel vendor, strukturat në nivel qendror dhe Agjencinë Kombëtare të Rinisë. Bazuar në gjetjet e raportit monitorues "Sfidat dhe Efektet e Zbatimit të Ligjit 75/19 Për Rininë" të cilin Kongresi Rinor Kombëtar e ka publikuar në fund të vitit 2021, puna e këtij viti konsiston jo vetëm në përditësimin e të dhënave të përfshira në këtë raport, por dhe analizimin dhe monitorimin e zhvillimeve që kanë ndodhur në periudhën Tetor-Qershor 2022. Metodologjia e raportit të këtij viti bazohet tek rishikimi i literaturës, dergimin e kërkesave për informacion ndaj institucioneve, zhvillimin e anketave me të rinjtë dhe OSHC-të dhe zhvillimin e fokus grupeve me aktorët kyç përgjegjës për mirëimplementimin e këtij ligji.

### **Për këtë arsye, kërkojmë të na vihen në dispozicion të dhënat e më poshme:**

1. Sipas parashikimeve Garancia Rinore do të vihej në jete gjysmën e dytë të vitit 2022. Cilat janë aktet ose projektaktet ligjore dhe nënligjore që kanë dalë gjatë kësaj periudhe për jetësimin e garancisë rinore? Cilat janë zhvillimet më të fundit lidhur me implementimin e Garancisë Rinore në Shqipëri?
2. Kur është parashikuar të miratohet Strategjia e Rinisë 2022 - 2029? Cili do të jetë buxheti në dispozicion për zbatimin e saj për vitin 2023?
3. Sa Qendra Rinore Aktive ka sot në Republikën e Shqipërisë, të menaxhuara nga Qeveria qendrore ose lokale?
4. Cilat janë emrat e 100 Shkollave në të cilat ka filluar programi i kodimit në klasat e para dhe cila është shpërndarja e tyre gjeografike?



# Aneksi III: Kërkesa për Informacion drejtuar AKR\_Qershor 2022

## Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Në kuadër të Programit të Kërkimit, Monitorimit dhe Vlerësimit, Kongresi Rinor Kombëtar me mbështetjen e Fondacionit Gjerman Konrad Adenauer ka vijuar punën për monitorimin e implementimit të "Ligjit për Rininë" dhe akteve nën ligjore të tij duke përfshirë: strukturat në nivel vendor, strukturat në nivel qendror dhe Agjencinë Kombëtare të Rinisë. Bazuar në gjetjet e raportit monitorues "Sfidat dhe Efektet e Zbatimit të Ligjit 75/19 Për Rininë" të cilin Kongresi Rinor Kombëtar e ka publikuar në fund të vitit 2021, puna e këtij viti konsiston jo vetëm në përditësimin e të dhënave të përfshira në këtë raport, por dhe analizimin dhe monitorimin e zhvillimeve që kanë ndodhur në periudhën Tetor-Qershor 2022. Metodologjia e raportit të këtij viti bazohet tek rishikimi i literaturës, dergimin e kërkesave për informacion ndaj institucioneve, zhvillimin e anketave me të rinjtë dhe OSHC-të dhe zhvillimin e fokus grupeve me aktorët kyç përgjegjës për mirëimplementimin e këtij ligji.

### **Për këtë arsye, kërkojmë të na vihen në dispozicion të dhënat e më poshme:**

1. Cili është bilanci i ngritjes së Këshillave Vendorë Rinorë në 61 bashki dëri në Tetor 2022?
2. Ju lutem na vini në dispozicion listen me: përfituesit e granteve të thirrjes 2 duke i ndarë sipas kategorive organizata rinore, organizata për të rinj dhe bashki; shumën e dedikuar secilit përfitues, emrat e bordit përzgjedhës të granteve; numri i aplikimeve për grante, krahasuar me numrin e aplikimeve të vitit 2021.
3. Nëse keni realizuar monitorim të granteve të vitit 2021, ju lutem na vini në dispozicion gjetjet e monitorimit
4. Ju lutem na vini në dispozicion një kopje të manualit për ngritjen e këshillave vendore rinore

# Aneksi IV: Kërkesa për Informacion drejtuar AKR\_Tetor 2022

## Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Në kuadër të Programit të Kërkimit, Monitorimit dhe Vlerësimit, Kongresi Rinor Kombëtar me mbështetjen e Fondacionit Gjerman Konrad Adenauer ka vijuar punën për monitorimin e implementimit të "Ligjit për Rininë" dhe akteve nën ligjore të tij duke përfshirë: strukturat në nivel vendor, strukturat në nivel qendror dhe Agjencinë Kombëtare të Rinisë. Bazuar në gjetjet e raportit monitorues "Sfidat dhe Efektet e Zbatimit të Ligjit 75/19 Për Rininë" të cilin Kongresi Rinor Kombëtar e ka publikuar në fund të vitit 2021, puna e këtij viti konsiston jo vetëm në përditësimin e të dhënave të përfshira në këtë raport, por dhe analizimin dhe monitorimin e zhvillimeve që kanë ndodhur në periudhën Tetor-Qershor 2022. Metodologjia e raportit të këtij viti bazohet tek rishikimi i literaturës, dergimin e kërkesave për informacion ndaj institucioneve, zhvillimin e anketave me të rinjtë dhe OSHC-të dhe zhvillimin e fokus grupeve me aktorët kyç përgjegjës për mirëimplementimin e këtij ligji.

### **Për këtë arsye, kërkojmë të na vihen në dispozicion të dhënat e më poshme:**

1. Lista e aktorëve që kanë përfituar nga thirrja e parë e Grantëve dhe shumën totale
2. Cilat janë zhvillimet kryesore që AKR po implementon lidhur me organizatat rinore?
3. A ka ndonjë zhvillim lidhur me rregjistrin Kombëtar të OSHC-ve?
4. Cila ka qenë ëcuria e implementimit të Ligjit Për Rininë në nivel lokal?
6. A ka ndonjë zhvillim lidhur me krijimin e organizatës përfaqësuese rinore?
7. Në juridiksionin e kujt ministrie është aktualisht AKR, asaj të Rinisë apo të Arsimit?

## Aneksi V: Intervistat gjysëm të strukturuar me anëtarët e Këshilli Kombëtar të Rinisë

### Drejtuar anëtarëve të Këshilli Kombëtar të Rinisë

- Si ka qenë kalimi nga një ministri në tjetrën? Ku jeni ndjerë se zëri juaj është dëgjuar më shumë?
- A jeni konsultuar nga MASR ose Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët e mbi strategjinë e Rinisë? A janë reflektuar sugjerimet tuaja në draft strategji? Cili është opinion juaj mbi procesin e hartimit dhe përmbajtjen e draftit?
- Cilat kanë qenë disa nga politikat, projektet, buxhetet që ju i keni propozuar ministrit dhe a janë miratuar ato? A keni pasur rëndësinë e duhur si organ pranë Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët?
- Si e gjykoni faktin se kryetar i KKR është vetë MSHRF? A ndikon kjo në lirinë tuaj për të mbledhur, organizuar, vepruar dhe ndikuar në politikat rinore?
- Cili është opinion juaj mbi thirrjen e parë për projekt propozime të AKR? Si e keni monitoruar procesin dhe si e gjykoni impaktin e iniciativave të mbështetura në terren?
- Si e gjykoni raportin midis vetë anëtarëve të KKR? A ka unanimitet midis tyre?
- Analiza SWOT

## Aneksi VI: Kërkesa për Informacion drejtuar 61 bashkive të vendit

### Seksioni 1 nga 11

Monitorimi/Vlerësimi i Implementimit të Ligjit 75/2019 "Për Rininë" në Nivel Lokal  
Në kuadër të programit të Kërkimit, Monitorimit dhe Vlerësimit, Kongresi Rinor Kombëtar me mbështetjen e Fondacionit Gjerman Konrad Adenauer po zbaton për të dytin vit rradhazi iniciativën "Drejtë një dialogu më efektiv/Seritë e Rezolutës së Rinisë" në kuadër të të cilit po zhvillon monitorimin e zbatimit të "Ligjit për Rininë" dhe akteve nën ligjore të tij duke përfshirë: strukturat në nivel vendor dhe ato në nivel qendror.

Në fund të kësaj iniciative do të publikohet një raport i cili synon të bëjë një pasqyrim të detajuar të situatës aktuale të implementimit të ligjit "Për Rininë" në secilën bashki, duke identifikuar nevojat dhe praktikat e mira në nivel lokal. Metodologjia e këtij raporti përfshin: desk research, fokus grupe, gjenerimin e të dhënave parësore (Kërkesë për informacion, intervista dhe pyetësorë) si dhe hulumtimin mbi të dhënat dytësore dhe analiza ekzistuese mbi çështjen. Ky pyetësor do të shërbejë për gjenerimin e të dhënave që do të bëhen pjesë e raportit përfundimtar. Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

*\*Ky pyetësor është hartuar në bazë të ligjit Nr. 119/2014 "PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT".  
Ju informojmë se të dhënat e paraqitura në këtë format do të përdoren vetëm për arsye studimore. Faleminderit për bashkëpunimin tuaj!*

## **Seksioni 2 nga 11**

Gjeneralitete

1. Emër Mbiemër
2. Kontakt (email):
3. Kontakt (Cel):
4. Bashkia që përfaqëson:
5. Rli/Pozicioni Juaj
6. Sa të rinj ka aktualisht në bashkinë tuaj?
7. Sa prej tyre janë femra dhe sa prej tyre janë meshkuj?

## **Seksioni 3 nga 11**

### **A. IMPLEMENTIMI I LIGJIT 75/2019 "PËR RININË"**

1. A vijon procesi i Implementimit të Ligjit për Rininë në Bashkinë tuaj?
2. Në cilën fazë është ky proces në Bashkinë tuaj? Shpjegoni shkurtimisht zhvillimet kryesore.
3. Në përmbushje të Nenit 7 mbi Njësitë e vetëqeverisjes vendore vlerësoni nga 1 tek 5 (1=aspak, 2=pak, 3=Disi, 4=Mjaftueshem dhe 5= plotësisht) sa i ka përmbushur bashkia juaj detyrimet ligjore që parashikon Ligji 75/2019 "Për Rininë"
  - a) pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të të rinjve, duke përcaktuar objektivat dhe prioritetet, si dhe të garantojnë zbatimin e tyre;
  - b) krijimin e këshillit vendor të rinisë;
  - c) organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve
  - ç) organizimin dhe ofrimin e veprimtarive për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve
  - d) nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre;
  - dh) financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta
  - e) krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë
  - ë) parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin e të drejtave të të rinjve

## **Seksioni 4 nga 11**

### **B.NGRITJA E KËSHILLAVE VENDORË RINORË**

- 1.A është ngritur Këshilli Vendor Rinor pranë Bashkisë suaj?
- 2.Nëse e keni ngritur KVR, ju lutem përgjigjuni pyetjeve me poshtë:
  - 2.a Cilat janë hapat që janë ndjekur për krijimin e tij? Listoni
  - 2.b Si është bërë përzgjedhja e anëtareve të kësajë strukture?
  - 2.c A keni bashkepunuar me organizatat e shoqërisë civile ne ngritjen e KVR?  
*Nëse po, specifikoni emrin e organizatës. Nëse jo, përgjigjuni Nuk ka.*
  - 2.d A është zbatuar parimi i transparencës, gjithëpërfshirjes dhe barazisë gjinore në krijimin e KVR në bashkinë tuaj?  
*Nëse po, shpjegoni shkurtimisht se si. Nëse jo, përgjigjuni nuk aplikohet.*
  - 2.e Sa anëtarë ka aktualisht KVR pranë bashkisë suaj?
  2. f Sa anëtarë femra dhe meshkuj ka aktualisht KVR pranë bashkisë suaj?
  - 2.g A janë përfshirë pjesëtarë nga grupet e marginalizuara në KVR në Bashkinë tuaj?
  - 2.h Nëse po, cilat?
    - 2.i Ju lutem listoni emër/mbiemër/email dhe nr.cel për secilin nga anëtarët e KVR pranë bashkisë suaj.
- 3.Nëse nuk e keni ngritur KVR, ju lutem përgjigjuni pyetjeve më poshtë:
  - 3.a Cilat janë sfidat/pengesat kryesore që keni hasur?
  - 3.b A mendoni se bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile do e kishte lehtësuar këtë proces?
  - 3.c Cilat janë nevojat që keni për tejkalimin e këtyre barrierave dhe ngritjen e Këshillit Vendor Rinor pranë Bashkisë suaj?
  - 3.d A ka bashkia juaj ekspertizë në hartimin dhe ngritjen e strukturave rinore?
- 4.Mbi të cilat parime/udhëzime është bërë ngritja e KVR në bashkinë tuaj?
- 5.A ka një standard/manual procedurash për ngritjen e KVR në nivel lokal?
- 6.Cilat janë kapacitetet (kapacitete njerëzore, program/plan veprimi/mbështetje financiare/infrastrukturë apo hapsira rinore) aktuale që disponon KVR në bashkinë tuaj? Listoni
- 7.Cilat janë nevojat imediate të KVR në bashkinë tuaj? Listoni

## **Seksioni 5 nga 11**

### **C.EKZISTENCA E NJË DOKUMENTI STRATEGJIK/ PLANI VEPRIMI DHE BUXHETI PËR IMPLEMENTIMIN E LIGJIT "PËR RININË"**

- 1.A ka bashkia juaj një plan/dokument strategjik për rininë?
  - 1.a Nëse po, ju lutem bashkëlidheni më poshtë.
  - 1.b Nëse jo, listoni arsyet.

- 2.Cilat janë nevojat imediate të të rinjve në qytetin tuaj? (Mund të zgjidhni deri në 3 opsione)
- 3.Cilat janë shtyllat kryesore të punës ku duhen bërë ndërhyrje në nivel të politikave publike për të rinjtë në bashkinë tuaj?
- 4.Cilat janë kapacitetet aktuale që disponon bashkia juaj për hartimin dhe funksionimin e strategjive/planeve të veprimit për rininë në nivel lokal?
- 5.Cilat janë nevojat aktuale lidhur me strategjitë lokale për rininë në bashkinë tuaj?
- 6.A mendoni se bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile do ta fasilite procesin e hartimit të këtyre planeve?
- 7.A ka bashkia juaj një plan monitorimi dhe vlerësimi të programeve apo iniciativave që ndërmerren në bashkinë tuaj?  
*Nëse po a ka nje vleresim se si është zbatuar ky plan?*  
*Nëse jo, cilat janë barrierat që pengojne hartimin dhe funksionimin e tij?*
- 8.A ka bashkia juaj një buxhet të dedikuar për rininë/programet apo iniciativat rinore për vitin 2022 e në vazhdim?  
*Nëse po, specifikoni vlerën totale. (Nëse është e mundur specifikoni programet për te cilat alokohet ky buxhet)*
- 10.Cilat janë burimet kryesore të të ardhurave për buxhetin që i alokohet rinisë në bashkinë tuaj?
- 11.Cilat janë mekanizmat ekzistues në nivel lokal që sigurojnë pjesëmarrjen e të rinjve në diskutimet mbi prioritetet e buxhetit ne nivel lokal?

Dopo la sezione 5

Continua alla sezione successiva

## **Seksioni 6 nga 11**

### **D.EKZISTENCA E NJË PERSONI PËRGJEGJËS APO NJË SPECIALISTI PËR ËSHTJET RINORE**

- 1.A ka aktualisht bashkia juaj një person përgjegjës/strukturë të dedikuar për rininë?
- 2.A është ky një person përgjegjës apo një specialist ekzistues të cilit i janë shtuar edhe kompetencat për rininë?
- 3.Specifikoni Emër, Mbiemër, Cel dhe Email të personit përgjegjës në bashkinë tuaj.
- 4.Nëse nuk ka një person përgjegjës, cilat janë barrierat që e kanë penguar këtë proces?
- 5.Cilat janë kapacitetet aktuale që disponon bashkia juaj për ofrimin e shërbimeve cilësore për të rinjtë?

6.Cilat janë nevojat kryesore që ka bashkia juaj lidhur me zhvillimin e burimeve njerëzore adeguate për të ofruar shërbime rinore cilësore?

### **Seksioni 7 nga 11**

#### **E.EKZISTENCA E NJË DATABASE TË ORGANIZATAVE LOKALE**

1.A ka bashkia juaj një databazë lokale të organizatave të shoqërisë civile që punojnë në bashkinë tuaj?

*Nëse po, a është kjo liste publike?*

*Nëse jo, cilat janë sfidat kryesore që pengojnë krijimin e një database për organizatat që punojnë në bashkinë tuaj?*

2.A e gjykoni se pasja e një database të tillë do ta fasilitonte punën tuaj dhe bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile në të ardhmen?

3.A mendoni se organizatat e shoqërisë civile mund t'ju vijjnë në ndihmë në këtë proces?

4.Cilat janë nevojat aktuale që bashkia juaj ka lidhur me mbledhjen e të dhënave për rininë në nivel lokal?

5.Cilat janë sfidat kryesore të stafit tuaj për mbledhjen e të dhënave për rininë në bashkinë tuaj?

### **Seksioni 8 nga 11**

#### **F.QASJA E BASHKISË NDAJ TË RINJVE: PROGRAMET DHE INICIATIVAT**

1.A është rinia prioritet për bashkinë tuaj?

*Nëse po, ku reflektohet rinia në punën/planin vendor në bashkinë tuaj?*

2.Cilat janë fushat prioritare për zhvillimin e rinisë në bashkinë tuaj?

3.Cilat janë kapacitetet aktuale që bashkia juaj disponon për rininë?

4.Cilat janë sfidat/barrierat kryesore në ofrimin e shërbimeve/mundësive të reja për të rinjtë në bashkinë tuaj?

5.Cili aktor mendoni se duhet të suportojë bashkitë në ofrimin e shërbimeve/hartimin e politikave për të rinjtë?

6.Listoni programet/iniciativat aktuale që ndërmerr bashkia juaj për të rinjtë në nivel lokal? (Vetëm iniciativa të bashkisë, jo të organizatave të shoqërisë civile)

## **Seksioni 9 nga 11**

### **G.ROLI I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË NIVEL LOKAL**

- 1.Si e gjykon bashkia juaj bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile ne bashkine tuaj?
- 2.Cilat janë nevojat kryesore për të siguruar një bashkëpunim më të mirë me organizatat e shoqërisë civile në bashkinë tuaj?
- 3.Cilat janë disa nga iniciativat kryesore/aktivitetet apo projektet që keni zbatuar apo jeni në proces zbatimi për të rinjtë në bashkinë tuaj (që janë në bashkëpunim më organizatat ose që implementohen nga vetë ato në bashkinë tuaj)?

## **Seksioni 10 nga 11**

### **KOMENTE/SUGJERIME TE TJERA**

Komente/sugjerime te tjera

## **Seksioni 11 nga 11**

Faleminderit për kohën dhe bashkëpunimin e treguar për plotësimin e këtij pyetësori. Kontributi juaj është një vlerë e shtuar e raportit dhe punës që ju bëni me të rinjtë. Suksese ne punën tuaj dhe uroj të mbetemi në kontakt për bashkëpunime të mëtejshme.

## **Aneksi VII: Pyetësori mbi Perceptimin e OSHC-ve mbi Implementimin e Ligjit për Rininë 75/2019**

### **Seksioni 1 nga 6**

Pyetësor për Perceptimin e Organizatave Rinore dhe për të Rinjtë mbi Implementimin e Ligjit të Rinisë

Në kuadër të programit të Kërkimit, Monitorimit dhe Vlerësimit, Kongresi Rinor Kombëtar me mbështetjen e Fondacionit Gjerman Konrad Adenauer po zbaton për të dytin vit rradhazi iniciativën " Drejtë një dialogu më efektiv/Seritë e Rezolutës së Rinisë" në kuadër të të cilit po zhvillon monitorimin e zbatimit të "Ligjit për Rininë" dhe perceptimin e organizatave rinore mbi implementimin e këtij ligji duke përfshirë nivelin e informimit të tyre dhe opinionin mbi strukturat që parashikohen të ngrihen si rrjedhim i këtij ligji. Metodologjia e këtij raporti bazohet tek metodologjia mikse dhe përfshin: desk research, fokus grupe, gjenerimin e të dhënave parësore (Kërkesë për informacion, intervista dhe pyetësorë) si dhe hulumtimin mbi të dhënat dytësore dhe analiza ekzistuese mbi çështjen. Ky pyetësor do të shërbejë për gjenerimin e të dhënave që do të bëhen pjesë e raportit përfundimtar.



Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Ju informojmë se të dhënat e paraqitura në këtë format do të përdoren vetëm për arsye studimore. Faleminderit për bashkëpunimin tuaj

## **Seksioni 2 nga 6**

### **TË DHËNA DEMOGRAFIKE:**

1. Organizata:\*
2. Emër/Mbiemër për personin e kontaktit: \*
3. Kontakt (email):\*
4. Qarku: \*
5. Bashkia:
6. Organizata juaj është:

## **Seksioni 3 nga 6**

### **A. NIVELI I INFORMIMIT MBI LIGJIN 75/2019 "PËR RININË":**

1. A keni dëgjuar më herët për Ligjin 75/2019 "PËR RININË"?\*
2. Nëse po, cili ka qenë burimi kryesor nga ku e keni marrë këtë informacion? \*  
*Nëse jo, specifikonit arsyen:*
3. A jeni në dijeni të ndryshimeve që Ligji 75/2019 "Për Rininë" sjell në sektorin rinor? \*
4. A jeni në dijeni të kompetencave dhe përgjegjësive që Ligji 75/2019 "Për Rininë" parashikon për Ministrin e Shtetit të Rinisë dhe Fëmijëve? \*
5. A jeni në dijeni të kompetencave dhe përgjegjësive që Ligji 75/2019 "Për Rininë" parashikon për Agjencinë Kombëtare të Rinisë?\*
6. A jeni në dijeni të kompetencave dhe përgjegjësive që Ligji 75/2019 "Për Rininë" parashikon për Këshillin Kombëtar të Rinisë?\*
7. A jeni në dijeni të rolit dhe përmbytjes që duhet të ketë Regjistri Elektronik për Rininë, bazuar në ligjin 75/2019 "Për Rininë"?\*
8. A jeni në dijeni të rolit dhe kompetencave që Ligji 75/2019 "Për Rininë" parashikon për Organizatën Kombëtare Përfaqësuese?\*
9. A jeni në dijeni të kompetencave dhe përgjegjësive që Ligji 75/2019 "Për Rininë" parashikon për Këshillat Vendor Rinor?\*

## **Seksioni 4 nga 6**

### **B. PERCEPTIMI I ORGANIZATAVE RINORE PËR IMPLEMENTIMIN E LIGJIT TË RINISË NË NIVEL QËNDROR**

1. A mendoni se ekzistenca e një Ministri të dedikuar për Rininë dhe Fëmijët rrit vëmëndjen kundrejt të rinjve në nivel institucional? \*

*Nëse po, përse? Nëse jo, përse?*

2. A keni marrë më herët pjesë në takime/aktivitete që janë realizuar nga MSHRF? \*

*Nëse po, ju lutem specifikoni. Nëse jo, përse?*

3. Në gjykimin tuaj, zhvillimet në 3 vitet e fundit në sektorin rinor e kanë përmiresuar apo përkeqësuar situatën e organizatave rinore në shoqëri? \*

4. Në përmbushje të nenit 7 mbi Ministrinë Përgjegjëse për Rininë vlerësoni nga 1 tek 5 (1=aspak, 5= plotësisht) sa i ka përmbushur Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët sipas jush detyrimet ligjore që parashikon Ligji 75/2019 "Për Rininë"\*

a) harton dhe propozon bazën ligjore, politikat, programet, strategjitë dhe veprimtaritë për rininë

b) planifikon buxhetin për financimin e veprimtarive në fushën e rinisë;

c) harton dhe publikon raportet e vlerësimit mbi situatën e të rinjve;

ç) monitoron zbatimin e politikave, si dhe të veprimtarive rinore;

d) monitoron standardet për ndërtimin e hapësirave rinore të sigurta dhe të aksesueshme për të rinjte

5. A keni dëgjuar më herët për Strategjinë e Rinisë 2022-2029? \*

6. A mendoni se ekzistenca e një dokumenti strategjik për rininë i shërben organizatave rinore për të adresuar më mirë problematikën e të rinjve dhe për të gjetur zgjidhje konkrete? \*

7. A keni marrë pjesë gjatë takimeve konsultuese që janë zhvilluar nga MSHRF lidhur me Strategjinë e Rinisë 2022-2029? \*

*Nëse po, ju lutem specifikoni. Nëse jo, përse.*

8. Në gjykimin tuaj, a mendoni se ekzistenca e një institucioni të dedikuar për rininë a do të përkthehet në një impakt më të gjerë dhe konkret për të rinjtë dhe organizatat rinore (psh. ekzistenca e një ministrie të dedikuar për rininë)? \*

9. A mendoni se ekzistenca e një Agjencie të dedikuar për Rininë rrit vëmëndjen dhe suportin ndaj të rinjve dhe organizatave që punojnë në sektorin rinor?\*

10. A keni marrë më herët pjesë në takime/aktivitete që janë realizuar nga AKR? \*

*Nëse po, ju lutem specifikoni. Nëse jo, përse?*

11. A mendoni se fondi në dispozicion nga AKR për organizatat rinore/për të rinjtë është i mjaftueshëm për të zgjidhur problematikat rinore? \*

12. Në përmbushje VENDIMIT NR. 681, DATË 2.9.2020 MËNYRËN E KRIJIMIT, TË ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË (AKR)" vlerësoni nga 1 tek 5 (1=aspak, 5= plotësisht) sa i ka përmbushur AKR sipas jush detyrimet ligjore që parashikon Ligji 75/2019 "Për Rininë"

a) realizimin e funksioneve që lidhen me mbështetjen, nxitjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve;

b) sigurimin e kushteve për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjen e të rinjve nga subjekte vendase ose të huaja;

c) nxitjen dhe zhvillimin e dialogut të strukturuar, për përfshirjen e sa më shumë palëve, me synim fuqizimin e pozitës së të rinjve në shoqëri;

ç) krijimin e mekanizmave për zhvillimin dhe nxitjen e politikave rinore, si dhe marrjen e vendimeve profesionale, cilësore e të pavarura, në përzgjedhjen e programeve dhe projekteve të financuara nga buxheti i shtetit

13. A keni aplikuar në thirrjet për projekt propozime që janë shpallur nga Agjencia Kombetare e Rinisë?

14. Cili është opinion juaj mbi menaxhimin e thirrjeve që janë lançuar deri më tani nga AKR?

15. A mendoni se fondet e menaxhuara nga AKR janë përdorur me efikasitet?

16. Në perceptimin tuaj ekzistenca e Këshillit Kombëtar të Rinisë ka sjellë ndryshime në sektorin rinor:

17. Në përmbushje të nenit 9 mbi Këshillin Kombëtar të Rinisë vlerësoni nga 1 tek 5 (1=aspak, 5= plotësisht) sa i ka përmbushur Këshilli Kombëtar i Rinisë sipas jush detyrimet ligjore që parashikon Ligji 75/2019 "Për Rininë"

a) i paraqet ministrit përgjegjës për rininë politikat prioritare, buxhetin dhe veprimtaritë në fushën e rinisë;

b) propozon drejtimet dhe programet kryesore për mbështetjen dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së të rinjve;

c) jep mendim për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe monitoron zbatimin e saj;

ç) miraton raportin vjetor mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe situatës së të rinjve.

18. A mendoni se Këshilli Kombëtar i Rinisë ka kapacitetet dhe burimet e duhura për të ofruar ekspertizë në politikat rinore dhe për të propozuar programe/veprimtari dhe buxhetin për rininë?

19. A mendoni se fakti që kryetar i Këshillit Kombëtar të Rinisë është njëherësh Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, luan një rol pozitiv në rolin e këtij këshilli apo limiton veprimtarinë dhe pavarësinë e anëtarëve të tij?

20. A mendoni se ekzistenca e një Organizate Kombëtare Përfaqësuese Rinore do të sillte ndryshim në sektorin rinor?

21. A mendoni se dispozitat aktuale të parashikuara në nenin 13 të Ligjit "75/2019 "Për Rininë" lidhur me Organizaten Kombëtare Përfaqësuese Rinore janë të qarta dhe të mjaftueshme për mirefunksionimin e saj?

## **Seksioni 5 nga 6**

### **C. PERCEPTIMI I ORGANIZATAVE RINORE PËR IMPLEMENTIMIN E LIGJIT TË RINISË NË NIVEL LOKAL**

1. A mendoni se ekzistenca e Këshillave Vendor Rinor e përmirëson rolin dhe pozitën e organizatave rinore në nivel lokal?
2. A mendoni se procesi i ngritjes dhe themelimit të Këshillave Vendor Rinor është ngritur në mënyrë transparente dhe në përputhje me Ligjin 75/2019 "Për Rininë"?
3. A mendoni se institucionet lokale kanë kapacitetet dhe burimet e duhura për të siguruar mirefunksionimin e këshillave vendor rinor dhe për të zgjidhur problematikat që ata adresojnë?
4. A mendoni se anëtarët e Këshillit Vendor Rinor në bashkinë tuaj kanë njohuritë dhe kapacitetet e duhura për të adresuar sic duhet problematikat e të rinjve dhe për të lobuar për zgjidhjen e tyre pranë institucioneve lokale?
5. A mendoni se fakti që krytari i Këshilli Vendor Rinor është njëherësh edhe Kryetari i Bashkisë, përforcon rolin e këtyre këshillave apo limiton autonominë dhe funksionimin e anëtarëve të tij?
6. A mendoni se bashkia juaj po bën mjaftueshëm për rininë?\*
7. A mendoni se bashkia juaj ka mjaftueshëm kapacitete njerëzore dhe resurse financiare që mundësojnë mirëfunksionimin e Këshillave Vendor Rinor dhe përmirësimin e problematikave të të rinjve në nivel lokal?
8. A ka bashkia juaj një Strategji Lokale për Rininë?
9. A ka aktualisht bashkia juaj minimumi një specialist/person përgjegjës për rininë?
10. A keni kontaktuar së paku një herë me specialistin apo personin përgjegjës për rininë në bashkinë tuaj?
11. A mendoni se institucionet lokale i janë përmbajtur parimeve të cilësuara në nenin 4 (parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, parimin e mundësive të barabarta dhe garantimit të pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse, parimin e lirisë së organizimit të iniciativave rinore, parimin e subsidiaritetit) të Ligjit 75/2019 "Për Rininë"?

12. A mendoni se implementimi i ligjit të rinisë në nivel lokal ka hasur problematika?

*Nëse po, cilat?*

13. A mendoni se organizatat/rrjetet rinore mund të vijnë në ndihmë në mirëfunksionimin e ligjit të rinisë në nivel lokal?

*Nëse po, cili mendoni se mund të jetë kontributi që mund të japin organizatat rinore në këtë proces?*

## **Seksioni 6 nga 6**

### **D. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

1. Cilat janë disa nga problematikat që ju keni evidentuar lidhur me implementimin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë"?

2. Listoni komentet apo sugjerimet tuaja për Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët lidhur me implemenitmin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë"?

3. Listoni komentet apo sugjerimet tuaja për Agjencinë Kombëtare të Rinisë lidhur me implemenitmin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë"?

4. Listoni komentet apo sugjerimet tuaja për Këshillin Kombëtar të Rinisë lidhur me implemenitmin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë"?

5. Listoni komentet apo sugjerimet tuaja për Bashkinë e qytetit tuaj lidhur me implemenitmin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë"?

6. Listoni komentet apo sugjerimet tuaja për Këshillin Vendor Rinor të bashkisë suaj lidhur me implemenitmin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë"?

7. Listoni komentet apo sugjerimet tuaja për Organizatat e Shoqërisë Civile lidhur me implemenitmin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë"?

Faleminderit për kohën dhe bashkëpunimin tuaj!

## **ANEKSI VIII: PYETËSOR MBI PERECPIMIN E TË RINJVE MBI IMPLEMENTIMIN E LIGJIT PËR RININË 75/2019 "PËR RININË"**

### **Seksioni 1 nga 7**

#### **Perceptimi i të Rinjve mbi Monitorimin/Vlerësimin e Implementimit të Ligjit 75/2019 "Për Rininë"**

Në kuadër të programit të Kërkimit, Monitorimit dhe Vlerësimit, Kongresi Rinor Kombëtar me mbështetjen e Fondacionit Gjerman Konrad Adenauer po zbaton për të dytin vit radhazi iniciativën "Drejtë një dialogu më efektiv/Seritë e Rezolutës së Rinisë" në kuadër të të cilit

po zhvillon monitorimin e zbatimit të "Ligjit për Rininë" dhe perceptimin e të rinjve mbi implementimin e këtij ligji duke përfshirë nivelin e informimit të tyre dhe opinionin mbi strukturat që parashikohen të ngrihen si rrjedhim i këtij ligji. Metodologjia e këtij raporti bazohet tek metodologjia mikse dhe përfshin: desk research, fokus grupe, gjenerimin e të dhënave parësore (Kërkesë për informacion, intervista dhe pyetësorë) si dhe hulumtimin mbi të dhënat dytësore dhe analiza ekzistuese mbi çështjen. Ky pyetësor do të shërbejë për gjenerimin e të dhënave që do të bëhen pjesë e raportit përfundimtar.

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Ju informojmë se të dhënat e paraqitura në këtë format do të përdoren vetëm për arsye studimore. Faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

## **Seksioni 2 nga 7**

### **TË DHËNA DEMOGRAFIKE**

1. Emër/Mbiemër:
2. Kontakt (email):
3. Moshë:
4. Qarku:
5. Bashkia:
6. Arsimi:
7. A jeni i angazhuar në organizata rinore ose për rininë?

## **Seksioni 3 nga 7**

### **A. NIVELI I INFORMIMIT MBI LIGJIN 75/2019 "PËR RININË"**

1. A keni dëgjuar më herët për Ligjin 75/2019 "PËR RININË"?  
*Nëse po, cili ka qenë burimi kryesor nga ku e keni marrë këtë informacion?*  
*Nëse jo, specifikoni arsyen:*
2. A jeni në dijeni të ndryshimeve që Ligji 75/2019 "Për Rininë" sjell në sektorin rinor?
3. A keni dëgjuar më herët për Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët?
4. A jeni në dijeni të kompetencave dhe përgjegjësive që Ligji 75/2019 "Për Rininë" parashikon për Ministrin e Shtetit të Rinisë dhe Fëmijëve?
5. A keni dëgjuar më heret për Agjencinë Kombëtare të Rinisë?
6. A jeni në dijeni të kompetencave dhe përgjegjësive që Ligji 75/2019 "Për Rininë" parashikon për Agjencinë Kombëtare të Rinisë?
7. A keni dëgjuar më herët për Këshillin Kombëtar të Rinisë?
8. A jeni në dijeni të kompetencave dhe përgjegjësive që Ligji 75/2019 "Për Rininë" parashikon për Këshillin Kombëtar të Rinisë?

9. A keni dëgjuar më herët për Regjistrin Elektronik për Rininë?

10. A jeni në dijeni të rolit dhe përmbajtjes që duhet të ketë Regjistri Elektronik për Rininë, bazuar në ligjin 75/2019 "Për Rininë"?

11. A keni dëgjuar më herët për Organizatën Kombëtare Përfaqësuese?

12. A jeni në dijeni të rolit dhe kompetencave që Ligji 75/2019 "Për Rininë" parashikon për Organizatën Kombëtare Përfaqësuese?

13. A keni dëgjuar më herët për Këshillat Vendor Rinor?

14. A jeni në dijeni të kompetencave dhe përgjegjësive që Ligji 75/2019 "Për Rininë" parashikon për Këshillat Vendor Rinor?

#### **Seksioni 4 nga 7**

#### **B. PERCEPTIMI I TË RINJVE PËR IMPLEMENTIMIN E LIGJIT TË RINISË NË NIVEL QËNDROR**

1. A mendoni se ekzistenca e një Ministri të dedikuar për Rininë dhe Fëmijët rrit vëmëndjen kundrejt të rinjve në nivel institucional?

*Nëse po, përse? Nëse jo, përse?*

2. A keni marrë më herët pjesë në takime/aktivitete që janë realizuar nga MSHRF?

*Nëse po, ju lutem specifikoni. Nëse jo, përse?*

3. Në gjykimin tuaj, zhvillimet në 3 vitet e fundit në sektorin rinor e kanë përmiresuar apo përkeqësuar situatën e të rinjve në shoqëri?

4. Në përmbushje të nenit 7 mbi Ministrinë Përgjegjëse për Rininë vlerësoni nga 1 tek 5 (1=aspak, 5= plotësisht) sa i ka përmbushur Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët sipas jush detyrimet ligjore që parashikon Ligji 75/2019 "Për Rininë"

a) harton dhe propozon bazën ligjore, politikat, programet, strategjitë dhe veprimtaritë për rininë

b) planifikon buxhetin për financimin e veprimtarive në fushën e rinisë

c) harton dhe publikon raportet e vlerësimit mbi situatën e të rinjve

ç) monitoron zbatimin e politikave, si dhe të veprimtarive rinore

d) monitoron standardet për ndërtimin e hapësirave rinore të sigurta dhe të aksesueshme për të rinjtë

5. A keni dëgjuar më herët për Strategjinë e Rinisë 2022-2029?

10. A mendoni se ekzistenca e një dokumenti strategjik për rininë i shërben atyre për të adresuar më mirë problematikat rinore dhe për të gjetur zgjidhje konkrete?

11. A keni marrë pjesë gjatë takimeve konsultuese që janë zhvilluar nga MSHRF lidhur me Strategjinë e Rinisë 2022-2029? *Nëse po, ju lutem specifikoni. Nëse jo, përse.*

12. A mendoni se ekzistenca e një Agjencie te dedikuar për Rininë rrit vëmëndjen dhe suportin ndaj të rinjve dhe organizatave që punojnë në sektorin rinor?\*
13. A keni marrë më herët pjesë në takime/aktivitete që janë realizuar nga AKR? \*  
*Nëse po, ju lutem specifikoni. Nëse jo, përse?*
14. A mendoni se fondi në dispozicion nga AKR për organizatat rinore/për të rinjtë është i mjaftueshëm për të zgjidhur problematikat rinore?
15. Në përmbushje VENDIMIT NR. 681, DATË 2.9.2020 MËNYRËN E KRIJIMIT, TË ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË (AKR)" vlerësoni nga 1 tek 5 (1=aspak, 5= plotësisht) sa i ka përmbushur AKR sipas jush detyrimet ligjore që parashikon Ligji 75/2019 "Për Rininë"\*
- a) realizimin e funksioneve që lidhen me mbështetjen, nxitjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve;
  - b) sigurimin e kushteve për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjen e të rinjve nga subjekte vendase ose të huaja;
  - c) nxitjen dhe zhvillimin e dialogut të strukturuar, për përfshirjen e sa më shumë palëve, me synim fuqizimin e pozitës së të rinjve në shoqëri;
  - ç) krijimin e mekanizmave për zhvillimin dhe nxitjen e politikave rinore, si dhe marrjen e vendimeve profesionale, cilësore e të pavarura, në përzgjedhjen e programeve dhe projekteve të financuara nga buxheti i shtetit
16. Në perceptimin tuaj ekzistenca e Këshillit Kombëtar të Rinisë ka sjellë ndryshime në përmbushje të nenit 9 mbi Këshillin Kombëtar të Rinisë vlerësoni nga 1 tek 5 (1=aspak, 5= plotësisht) sa i ka përmbushur Këshilli Kombëtar i Rinisë sipas jush detyrimet ligjore që parashikon
- a) i paraqet ministrit përgjegjës për rininë politikat prioritare, buxhetin dhe veprimtaritë në fushën e rinisë;
  - b) propozon drejtimet dhe programet kryesore për mbështetjen dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së të rinjve;
  - c) jep mendim për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe monitoron zbatimin e saj;
  - ç) miraton raportin vjetor mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe situatës së të rinjve.
17. A mendoni se Këshilli Kombëtar i Rinisë ka kapacitetet dhe burimet e duhura për të ofruar ekspertizë në politikat rinore dhe për të propozuar programe/veprimtari dhe buxhetin për rininë?
18. A mendoni se fakti që kryetar i Këshillit Kombëtar të Rinisë është njëherësh Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, luan një rol pozitiv në rolin e këtij këshilli apo limiton veprimtarinë dhe pavarësinë e anëtarëve të tij? \*
19. A mendoni se ekzistenca e një Organizate Kombëtare Përfaqësuese Rinore do të sillte ndryshim në sektorin rinor? \*



20. A mendoni se dispozitat aktuale të parashikuara në nenin 13 të Ligjit "75/2019 "Për Rininë" lidhur me Organizaten Kombëtare Përfaqësuese Rinore janë të qarta dhe të mjaftueshme për mirefunksionimin e saj?

### **Seksioni 5 nga 7**

#### **C. PERCEPTIMI I TË RINJVE PËR IMPLEMENTIMIN E LIGJIT TË RINISË NË NIVEL LOKAL**

1. A mendoni se ekzistenca e Këshillave Vendor Rinor e përmirëson rolin dhe pozitën e të rinjve në nivel lokal?
2. A mendoni se procesi i ngritjes dhe themelimit të Këshillave Vendor Rinor është ngritur në mënyrë transparente dhe në përputhje me Ligjin 75/2019 "Për Rininë"?
3. A mendoni se institucionet lokale kanë kapacitetet dhe burimet e duhura për të siguruar mirefunksionimin e këshillave vendor rinor dhe për të zgjidhur problematikat që ata adresojnë?
4. A mendoni se anëtarët e Këshillit Vendor Rinor në bashkinë tuaj kanë njohuritë dhe kapacitetet e duhura për të adresuar sic duhet problematikat e të rinjve dhe për të lobuar për zgjidhjen e tyre pranë institucioneve lokale?
5. A mendoni se fakti që kryetari i Këshilli Vendor Rinor është njëherësh edhe Kryetari i Bashkisë, përforcon rolin e këtyre këshillave apo limiton autonominë dhe funksionimin e anëtarëve të tij?
6. A mendoni se bashkia juaj po bën mjaftueshëm për rininë?
7. A mendoni se bashkia juaj ka mjaftueshëm kapacitete njerëzore dhe resurse financiare që mundësojnë mirëfunksionimin e Këshillave Vendor Rinor dhe përmirësimin e problematikave të të rinjve në nivel lokal?
8. A keni dëgjuar më herët për Strategji Lokale për Rininë në Bashkinë tuaj?
9. A mendoni se ka bashki juaj një Strategji për zhvillimin e politikave rinore në Bashkinë tuaj?
10. A jeni në dijeni se Ligji 75/2019 "Për Rininë" parashikon që secila bashki të ketë minimumi një specialist/përsone përgjegjës për rininë?
11. A keni kontaktuar së paku një herë me specialistin apo personin përgjegjës për rininë në bashkinë tuaj?
12. A mendoni se informimi i të rinjve mbi implementimin e ligjit në nivel lokal është bërë në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë grupimet e të rinjve?
13. A mendoni se institucionet lokale i janë përmbajtur parimeve të cilësuar në nenin 4 /të Ligjit 75/2019 "Për Rininë"?

14. A mendoni se implementimi i ligjit të rinisë në nivel lokal ka hasur problematika?  
*Nëse po, cilat?*

### **Sezione 6 di 7**

#### **D. PERCEPTIMI I TË RINJVE MBI ROLIN E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË IMPLEMENTIMIN E LIGJIT TË RINISË**

1. A mendoni se organizatat e shoqërisë civile do të kishin sjellë një impakt pozitiv në implementimin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë"?
2. A mendoni se bashkëpunimi midis organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të pushtetit lokal do të kishte sjellë një rezultat më të prekshëm në zgjidhjen e problematikave të të rinjve në nivel lokal?
3. A mendoni se niveli i besimit nga të rinjtë është më i lartë tek institucionet e pushtetit lokal apo organizatat e shoqërisë civile?
4. A mendoni se organizatat e shoqërisë civile duhet të luajnë një rol më aktiv në informimin e të rinjve dhe fuqizimin e tyre lidhur me ndryshimet që parashikon të sjellë Ligji 75/2019 "Për Rininë"?

### **Seksioni 7 nga 7**

#### **E. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

1. Cilat janë disa nga problematikat që ju keni evidentuar lidhur me implementimin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë"?
2. Listoni komentet apo sugjerimet tuaja për Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët lidhur me implemenitmin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë"?
3. Listoni komentet apo sugjerimet tuaja për Agjencinë Kombëtare të Rinisë lidhur me implemenitmin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë"?
4. Listoni komentet apo sugjerimet tuaja për Këshillin Kombëtar të Rinisë lidhur me implemenitmin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë"?
5. Listoni komentet apo sugjerimet tuaja për Bashkinë e qytetit tuaj lidhur me implemenitmin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë"?
6. Listoni komentet apo sugjerimet tuaja për Këshillin Vendor Rinor të bashkisë se qyteti tuaj lidhur me implemenitmin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë"?
7. Listoni komentet apo sugjerimet tuaja për Organizatat e Shoqërisë Civile lidhur me implemenitmin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë"?